



## RAPORTI I DYTË I MONITORIMIT

# KOSOVA NË PROCESIN E BERLINIT:

**Deri në çfarë mase janë përmbushur  
angazhimet për Tregun e Përbashkët  
Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër?**

Shtator 2024

supported by:



CRTA:



institut  
alternativa



E drejta e autorit © 2024. Instituti Demokratik i Kosovës (IDK).

Instituti Demokratik i Kosovës rezervon të gjitha të drejtat dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë, mekanike ose elektronike, përfshirë fotokopjimin ose ndonjë material tjetër të sistemit të ruajtjes dhe rikthimit, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate ose materiale të ndryshme të këtij botimi është i detyruar të sqarojë burimin nga i cili ka marrë ato citime ose materiale të përdorura.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes opsioneve të dhëna më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr.239.

10,000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Ky raport u realizua në kuadër të projektit “*Diplomacia parlamentare: Bashkëpunimi rajonal përmes dialogut të zgjeruar parlamentar*”, i zbatuar me organizatat partnere nga rajoni me mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane të Punëve të Jashtme.

Përmbytja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Ministrisë Federale Gjermane të Punëve të Jashtme.



### HYRJE

Me 28 gusht të vitit 2024, janë bërë 10 vite nga samiti i Berlinit, aty ku u lansua për herë të parë i ashtuquajtur i Procesit i Berlinit. Kjo nismë diplomatike e Kancelarës gjermane të asaj kohe Angela Merkel, synonte zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura të brendshme dhe ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, arritjen e pajtimit brenda dhe midis shoqërive në rajon, rritjen e bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe vendosjen e themeleve për rritje të qëndrueshme.<sup>1</sup>

Përveç shteteve të Ballkanit Perëndimor, pjesëmarrëse në procesin e Berlinit janë edhe institucionet e BE-së, organet financiare ndërkombëtare, si dhe organizatat e shoqërisë civile, të rinjtë dhe bizneset brenda rajonit.<sup>2</sup>

Që nga viti 2014, në kuadër të këtij procesi janë mbajtur samite vjetore, duke mbledhur udhëheqës nga Ballkani Perëndimor, shtetet anëtare të BE-së dhe palët përkatëse të interesit për të planifikuar dhe sinkronizuar veprimet e përbashkëta. Samiti i fundit është mbajtur në kryeqytetin e Shqipërisë në Tiranë, në tetor të vitit 2023. Kjo ka qenë hera e parë që një samit i tillë është mbajtur jashtë kufijve të Bashkimit Evropian. Këto samite në fokus kanë tema të ndryshme si ekonomia, infrastruktura, sundimi i ligjit, siguria dhe nxitja e bashkëpunimit mes të rinjve.<sup>3</sup>

*Kosova është një nga vendet që janë pjesë e procesit të Berlinit, por çfarë do të thotë*

*procesi i Berlinit për Kosovën?*

Përfaqësimi i Kosovës në Procesin e Berlinit jo vetëm që i ka mundësuar një platformë për angazhim të barabartë me vendet rajonale dhe BE-në, por gjithashtu ka forcuar pozicionin e Kosovës si një pjesëmarrëse aktive në formimin e iniciativave të bashkëpunimit rajonal. Përmes pjesëmarrjes aktive, Kosova ka kontribuar në forcimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ka luajtur një rol thelbësor në përparimin e objektivave të partneritetit Berlin-Bruksel.<sup>4</sup> Bashkimi në iniciativa si Rrjeti Trans-Evropian i Transportit (TEN-T) dhe nënshkrimi i marrëveshjeve si Traktati i Bashkëpunimit në Transport (TKT) në Samitin e Triestes janë hapa konkrete që tregojnë angazhimin e Kosovës për përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhshmërisë së saj në kuadrin më të gjerë evropian.

Përveç kësaj, mbajtja e parimeve të përcaktuara në marrëveshjet për Marrëdhëniet e Mira fqinjësore dhe Bashkëpunimin Rajonal nënvizon përkushtimin e saj për forcimin e stabilitetit, paqes dhe përparimit në rajon. Duke plotësuar këto obligime dhe duke marrë pjesë aktivisht në iniciativat rajonale, Kosova jo vetëm që ka forcuar pozicionin e vet, por gjithashtu ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në objektivat më të gjera të promovimit të bashkëpunimit, integritetit dhe zhvillimit në Ballkanin Perëndimor.<sup>5</sup>

1 Shih më shumë në faqen zyrtare të Procesit të Berlinit në, <https://www.berlinprocess.de/en/what-is-the-berlin-process>

2 Po aty.

3 Stiftung Wissenschaft und Politik, Procesit i Berlinit në Ballkanin Perëndimor: Ide të mëdha, zbatim i vështirë në, <https://www.swp-berlin.org/10.18449/2022C70/>

4 Shih Raportin e BPRG, "Procesi i Berlinit për Ballkanin Perëndimor: Përfitimet dhe Sfidat për Kosovën, fq.13. në [https://balkangroup.org/wp-content/uploads/2018/01/Procesi-i-Berlinit-p%C3%ABr-Ballkanin-Per%C3%ABndimor\\_P%C3%ABrfitimet-dhe-sfidat-p%C3%ABr-Kosov%C3%ABn\\_Shqip.pdf](https://balkangroup.org/wp-content/uploads/2018/01/Procesi-i-Berlinit-p%C3%ABr-Ballkanin-Per%C3%ABndimor_P%C3%ABrfitimet-dhe-sfidat-p%C3%ABr-Kosov%C3%ABn_Shqip.pdf)

5 Po aty.

Mirëpo, mosmarrëveshjet e vazhdueshme dypalëshe, veçanërisht ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës, që rrjedhin nga kundërshtimet e këtyre dy shteteve për statusin e pavarur të Kosovës, kanë vendosur barriera për Procesit të Berlinit. Këto mosmarrëveshje kanë penguar zbatimin e marrëveshjeve që rrjedhin nga ky procesi, duke penguar bashkëpunimin e mirëfilltë rajonal dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.<sup>6</sup>

Me gjithë këto sfida, Kosova ka vazhduar të zbatojë zotimet që rrjedhin nga Procesi i Berlinit. Në shkurt të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës ratifikoi tri marrëveshje të nënshkruara në kuadër të Procesit të Berlinit me 2/3 e votave,<sup>7</sup> duke shënuar vendin e dytë në rajon që ratifikoi me shpejtësi të tre marrëveshjet.<sup>8</sup> Marrëveshjet e ratifikuara përfshijnë Marrëveshjen për lëvizjen e lirë me karta identiteti në Ballkanin Perëndimor, Marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë brenda rajonit dhe njohjen e kualifikimeve profesionale posaçërisht për mjekët, stomatologët dhe arkitektët sipas kornizës së Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).<sup>5</sup> Në tetor të vitit 2023 në Samitin e Tiranës, marrëveshja për njohjen e kualifikimeve u zgjerua tutje me profesione të reja, atë të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive. Këto marrëveshje janë Kosova miratuar nga Qeveria në prill të vitit 2024<sup>9</sup>, me 6 muaj vonesë, ndërsa nga Kuvendi në maj 2024.<sup>10</sup>

Në ndërkohë, Qeveria ka miratuar Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024 – 2028. PKIE është dokument ligjërishit i detyrueshëm për të gjitha organet e administratës shtetërore, të cilat obligohen të zbatojnë masat afatshkurtra nën përgjegjësinë e tyre për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe kritereve të tjera për integrim në Bashkimin Evropian.

Përveç marrëveshjeve kryesore, Kosova është angazhuar për ekzekutimin e Planeve të Veprimit që rrjedhin nga Procesi i Berlinit, në fusha të ndryshme dhe zotimet e liderëve të rajonit të bëra gjatë samiteve të Berlinit. Këto zotime janë baza e nismave për tema si Tregu i Përbashkët Rajonal dhe Agjenda e Gjellbër. Kosova është një nga nënshkrueset e “Deklaratës së Sofjes” që definon obligimet për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe Deklaratën për Zhvillimin e Tregut të Përbashkët Rajonal të vitit 2020.

Për të evidentuar shkallën e përmbushjes së zotimeve nga ana e Kosovës sa u përket dy prej shtyllave të procesit të Berlinit, Tregun e Përbashkët Rajonal, me fokus Digjitalizimin dhe Agjendën e Gjellbër me fokus Dekarbonizimin, KDI ka publikuar raportin e parë të monitorimit në dhjetor 2023.<sup>11</sup>

Ndërsa, më poshtë do të shpalosen të gjeturat e raportit të dytë të monitorimit me informacione të përditësuara për fushat e lartpërmendura, për periudhën janar-korrik 2024.

6 Koha Net, “Kurti kërkon të zbatohet marrëveshja për lëvizje të lirë mes Kosovës e Bosnjës”, 11 prill 2024, në <https://www.koha.net/arberi/416045/kurti-Komisionit-Evropianrkon-te-zbatohet-marreveshja-per-levizje-te-lire-mes-kosoves-e-bosnjes>

7 Portali Ekonomia Online, 23 shkurt, 2023 në, <https://ekonomiaonline.com/ratifikohen-tri-marreveshje-te-procesit-te-berlinit/>

8 Telegrafi, Shkurt, 2023, <https://shorturl.at/7oh3R>

9 Zyra e Kryeministrit, Vendimet e Qeverisë nga mbledhja 200, në <https://kryeministri.rks-gov.net/vendimet-e-mbledhjes-se-qeverise/>

10 Evidenca e Ligjeve të Kuvendit të Kosovës në, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaeligjeve\\_YEeRbw38rY.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaeligjeve_YEeRbw38rY.pdf)

11 Shih Raportin e parë të monitorimit në, <https://shorturl.at/SeLz1>



### METODOLOGJIA

Raporti i dytë i monitorimit synon të analizojë në mënyrë të detajuar përparimet në zbatimin e angazhimeve të marra nga Qeveria e Kosovës brenda kornizës së Procesit të Berlinit. Fokusi kryesor i këtij Raporti do të jetë përsëri Tregu i Përbashkët Rajonal dhe Agjenda e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Periudha e analizuar përmban zhvillimet nga janari deri në korrik të vitit 2024. Audienca kryesore do të përfshijë deputetët dhe stafin parlamentar të Kuvendit të Kosovës, sidomos ata të komisioneve që kanë në fushëveprim çështjet që ndërlidhen me Procesin e Berlinit dhe publikun e gjerë.

Në veçanti, analizohet progresi i zbatimit të Planeve të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal, duke u përqendruar në fushën e digjitalizimit dhe agjendën e gjelbër, duke evidentuar progresin në sferën e dekarbonizimit. Në kuadër të kësaj, pasqyrohen të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga institucionet e Kosovës në këto fusha përgjatë periudhës së lartpërmendur.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të ofrojë një pamje të hollësishme mbi përmbushjen e zotimeve të Procesit të Berlinit nga ana e Kosovës, gjatë këtij viti. Këto informacione do të jenë një burim i rëndësishëm për deputetët dhe stafin parlamentar për të vlerësuar dhe për të mbajtur llogaridhënëse Qeverinë sa i përket realizimit të agjendës së Procesit të Berlinit.

Për më tepër Raporti i dytë i monitorimit adreson obligimet e institucioneve përgjegjëse për përmbushjen e zotimeve dhe sygjeron hapat e ardhshëm për

zbatimin efektiv, të cilat burojnë edhe nga rekomandimet e raportit paraprak. Gjithashtu, Raporti identifikon dhe të adreson sfidat të cilat potencialisht mund të minojnë progresin.

Raporti bazohet në metodat kryesore të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë hulumtimin analitik të burimeve ekzistuese të të dhënave dhe realizimin e intervistave me institucionet, agjencitë dhe akterë të tjerë relevant. Është përdorur një gamë e gjerë burimesh të dhënash, duke përfshirë dokumente zyrtare, raporte nga institucionet e Ballkanit Perëndimor dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, deklaratat nga udhëheqësit rajonalë, raporte mediatike dhe intervista me institucionet vendore. Për analizën e të dhënave, është përdorur analiza e të dhënave parësore, përmbajtja dhe analiza e intervistave, si dhe metoda e krahasimore. Të dhënat janë të prezantuara në tabela të renditura sipas Planeve të veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër. Për më tepër është bërë krahasim mes periudhës aktuale dhe asaj nga Raporti i parë, për të vlerësuar progresin në implementimin e aktiviteteve dhe projekteve që burojnë nga Planet e Veprimit.

### 1. ROLI MBIKËQYRËS I KUVENDIT NDAJ QEVERISË NË PËRMBUSHJEN E ZOTIMEVE TË PROCESIT TË BERLINIT

Të dhënat e ofruara në Raportin e parë të monitorimit kanë shërbyer si një bazë e mirë për deputetët dhe stafin parlamentar për të ndjekur progresin e zbatimit të zotimeve të

procesit të Berlinit nga ana e Qeverisë. Në këtë mënyrë Kuvendi, në kuadër të rolit të tij mbikëqyrës ka përfshirë edhe procesin e Berlinit si një proces i një rëndësie të lartë. Raporti i dytë i monitorimit synon të avancojë më tej rolin e Kuvendit në procesin e Berlinit, duke ofruar informacione të përditësuara për deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe stafin parlamentar për vitin 2024, gjegjësisht periudhën janar-korrik 2024. Fuqizimi i Kuvendit të Kosovës për të shqyrtuar dhe mbajtur qeverinë përgjegjëse për angazhimet e saj në Procesin e Berlinit jo vetëm që forcon qeverisjen e brendshme, por gjithashtu nënvizon angazhimin e Kosovës ndaj iniciativave rajonale, duke kontribuar në stabilitetin dhe përparimin më të gjerë brenda Ballkanit Perëndimor.

Kuvendi si institucioni më i lartë ligjvënës në vend është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e të gjitha nismave ligjore që ndërliken me detyrimet që ka Kosova karshi “Procesit të Berlinit”. Çështjet më të rëndësishme të cilat Kuvendi ka mbuluar në këtë periudhë janë miratimi i ligjeve së bashku me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat burojnë nga ky proces. Gjatë sesionit pranveror janar-korrik 2024, Kuvendi ka miratuar tri projektligje që ndërliken me procesin e Berlinit. Ndërsa, një situatë problematike është krijuar me ardhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvend për ratifikim.

Kështu, disa marrëveshje për më shumë se një vit nuk arritën të ratifikohen nga ana e deputetëve në Kuvend. Në mesin e 20 marrëveshjeve që janë ratifikuar gjatë sesionit pranveror të Kuvendit, 12 prej tyre<sup>12</sup> janë marrëveshje të cilat ndërliken me Procesin e Berlinit”.

Ndërsa siç elaborohet më poshtë ende ka një numër të projektligjeve të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi në mënyrë që Kosova të përmbushë obligimet që dalin nga planet e veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal-Digjitalizimin dhe Agjendën e Gjelbër-Dekarbonizimit.

## 2. SA JANË ZBATUAR ZOTIMET E PROCESIT TË BERLINIT NGA ANA E KOSOVËS NË FUSHËN E DIGJITALIZIMIT DHE DEKARBONIZIMIT?

Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër zotime të reja në kuadër të procesit të Berlinit gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024. Në nëntor të vitit 2023 në Samitin e Tiranës u nënshkrua një marrëveshje e re dhe gjashtë deklaratatë të përbashkëta mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat synojnë të thellojnë Tregun e Përbashkët Rajonal. Marrëveshja e nënshkruar për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale u shtri edhe në katër profesione të reja: atë për infermierët, mamitë, farmacistët, si dhe kirurgët veterinar. Kjo marrëveshje u mundëson qytetarëve që në shtetin pritës të ushtrojnë të njëjtin profesion për të cilin janë kualifikuar në shtetin amë dhe ta realizojnë këtë në kushte jo më pak të favorshme se sa qytetarët e shtetit pritës. **Kuvendi i Kosovës e ka ratifikuar këtë marrëveshje në maj 2024, me 6 muaj vonesë.**

Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka Miratuar Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024 – 2028 në prill 2024. Në këtë Plan theksohet se, në kontekstin e bashkëpunimit

<sup>12</sup> Klan Kosova, qasur në <https://klankosova.tv/marreveshjet-nderkombetare-10-votohen-dy-rrezohen-dhe-nje-shtyhet/>





## KOSOVA NË PROCESIN E BERLINIT: Deri në çfarë mase janë përmbushur angazhimet për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër?

rajonat dhe integritet në BE, Republika e Kosovës është e përkushtuar të zbatojë obligimet që dalin nga Planet e Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit.<sup>13</sup>

Më poshtë dhe në dy Shtojcat e këtij raporti janë të paraqitura në mënyrë të detajuar të dhënat se sa Kosova ka përmbushur obligimet që burojnë nga procesi i Berlinit për dy fushat: Tregun e Përbashkët Rajonal pjesën e Digjitalizimit dhe Agjendën e Gjelbër, pjesën e Dekarbonizimit.

### 2.1 NJË PASQYRË E PËRSGJITHSHME E NIVELIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR TREGUN E PËRBASHKËT RAJONAL: DIGJITALIZIMI

NIVELI I ZBATIMIT				
Plani i veprimit	Asnjë	I vogël	Mesatar	Transformues
Tregu i përbashkët rajonal: Digjitalizimi			√	

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese (janar-korrik 2024) Kosova ka vazhduar të ketë përparim të moderuar në zbatimin e Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal, konkretisht pjesën e Digjitalizimit, që buron nga Procesi i Berlinit.

**Kosova ka avancuar në shtrirjen e internetit dhe që nga viti 2022 pothuajse 100% e qytetarëve të Kosovës kanë qasje në internet.** Përmes Programit të Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE), i mbështetur nga Banka Botërore, është bërë shtrirja e internetit me fibra optike në 203 fshatra,

përfshirë shkolla dhe qendra shëndetësore, duke mundësuar që çdo banor të ketë qasje në internet me shpejtësi të lartë, duke e vënë Kosovën para shteteve të rajonit. Ky projekt ka përfshirë ndërlidhjen e gjashtë kullave celulare me teknologjinë e fibrave optike për rrjetet 5G, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve të internetit celular. Përdorimi i rrjeteve mobile 4G dhe 5G është në rritje të vazhdueshme, duke ofruar mundësi më të mira për komunikim dhe shërbime online për qytetarët.

Përveç kësaj, Kosova ka avancuar në përmirësimin e infrastrukturës digjitale dhe lidhjes së rrjetit akademik dhe kërkimor. Rrjeti Kosovar i Kërkimit dhe Edukimit (KREN) është lidhur me rrjetin pan-evropian GEANT, duke mundësuar qasje më të mirë në burime dhe mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar. Plani për të lidhur 220 shkolla me këtë rrjet deri në fund të vitit 2024 do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe në rritjen e mundësive për kërkime shkencore. Strategjia e Arsimit 2022-2026 përqendrohet në përmirësimin e aftësive digjitale për qytetarët, duke përfshirë zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe krijimin e qendrave edukative në këtë fushë. Këto përpjekje synojnë të rrisin ndjeshëm aftësitë teknologjike të të rinjve dhe të rrisin konkurrueshmërinë e Kosovës në nivel global. Megjithatë, Kosova nuk ka përfshirë siç duhet arsimimin digjital për grupet e margjinalizuara dhe pakicat, përfshirë komunitetin rom, në strategjitë dhe planet e saj. Ky mungesë përfshirjeje pengon mundësitë për zhvillim dhe barazi në shoqëri.

Kosova ka përmirësuar kualitetin e statistikave duke kryer një regjistrim të ri të



popullsisë në prill 2024 dhe duke dërguar statistika më të shpeshta në EUROSTAT. Megjithatë, është e nevojshme që të vazhdojë përmirësimi në këtë drejtim duke forcuar Agjencinë e Statistikave për të siguruar mbledhjen dhe raportimin më të saktë dhe të plotë të të dhënave.

Kosova nuk ka arritur ende të realizojë disa objektiva të rëndësishme që burojnë nga Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal, pjesa e Digjitalizimit. **Përprjekjet për të zhvilluar qytetet inteligjente janë ende në faza të hershme.** Ndryshe nga kryeqyteti Prishtina, e cila ka bërë disa përparime në këtë drejtim, qytetet e tjera kanë avancuar vetëm pak ose aspak në krijimin e strukturave dhe teknologjive të nevojshme për qytetet inteligjente. Kjo tregon nevojën për përprjekje të mëtejshme dhe strategji të fokusuara për të avancuar në këtë drejtim.

**Në aspektin në nivel rajonal, ka ende nevojë për reduktime të mëtejshme në çmimet e Roaming dhe një model RLAH+ (Roam Like at Home Plus) për të arritur zero tarifa Roaming, që do të ofronte përfitime të mëdha për qytetarët në Kosovë dhe në rajon.** Për më tepër, Kosova përballet me sfida të tjera që lidhen me marrëdhëniet jo të mira me Serbinë dhe Bosnjën, të cilat pengojnë përparimin në bashkëpunimin rajonal dhe zbatimin e strategjive të përbashkëta për zhvillimin digjital dhe përmirësimin e lidhjeve rajonale. Kosova ka miratuar ligjin dhe strategjinë për sigurinë kibernetike, por përballet me shumë kërcënime kibernetike. Prandaj, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi rajonal për të përballuar më mirë këto kërcënime dhe për të përmirësuar mbrojtjen kibernetike në nivel rajonal. Të dhënat e detajuara për secilën pikë të Planit të Veprimit lidhur me Digjitalizimin janë të

paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Raporti. Në bazë të të dhënave të kësaj periudhe, KDI paraqet më poshtë rekomandimet për Kuvendin e Kosovës, duke synuar të fuqizojë rolin e tij mbikëqyrës ndaj Qeverisë, në monitorimin e zbatimit të obligimeve që dalin nga procesi i Berlinit nga Qeveria:

## REKOMANDIME

1. Kuvendi duhet të monitorojë zbatimin e Ligjeve, Strategjive dhe Planeve të Veprimit që lidhen me fushën e Digjitalizimit si: Ligjin për Siguri Kibernetike, Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2023-2027, Strategjinë e Arsimit 2022-2026, Programin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE) dhe Agjendën Digjitale 2030. Po ashtu, duhet të iniciojë avancimin e këtyre Strategjive dhe programeve, për të përfshirë komunitetet e pafavorizuara si personat me aftësi të kufizuara dhe komunitet jo shumicë në veçanti komunitetin rom, duke ofruar trajnime dhe mundësi digjitale për këto grupe.
2. Kuvendi duhet të mbikëqyrë procesin e shtrirjes së internetit duke kërkuar nga Qeveria informacione lidhur me shtrirjen dhe funksionimin e internetit në pjesën veriore dhe kompanitë që ofrojnë shërbime të internetit në atë pjesë.
3. Në kontekstin e zhvillimeve në fushën e Inteligjencës Artificiale Kuvendi duhet të iniciojë **draftimin e një Ligji për Inteligjencën Artificiale**, në përputhje me legjislacionin e BE-së. Adoptimi i një ligji për inteligjencën artificiale është i rëndësishëm për të garantuar përdorimin etik të teknologjive artificiale, për të





## KOSOVA NË PROCESIN E BERLINIT: Deri në çfarë mase janë përmbushur angazhimet për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër?

stimuluar inovacionin duke krijuar një mjedis që mbrohet qytetarët nga rreziqet dhe keqpërdorimet e mundshme.

4. Kuvendi duhet të avokojë për **përmirësimin e kualitetit të statistikave të Kosovës** duke kërkuar nga Qeveria fuqizim të kapaciteteve për Agjencinë e Statistikave të Kosovës, në kuptim të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve tjera të nevojshme.
5. Kuvendi duhet të jetë më aktiv në mbikëqyrjen dhe pjesëmarrjen në zhvillime inovative siç janë iniciativat për krijimin e qyteteve inteligjente, duke bashkëpunuar me komunat në këtë drejtim dhe ofruar asistencën e nevojshme.

Në përfundim, angazhimi aktiv i Kuvendit të Kosovës është thelbësor për të përmbushur obligimet e Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal, pjesa e digjitalizimit. Vetëm përmes mbikëqyrjes aktive dhe iniciativave të koordinuara nga Kuvendi, Kosova mund të sigurojë përmirësimin e infrastrukturës digjitale, zhvillimin e politikave për Inteligjencën Artificiale, dhe avancimin e statistikave të sakta, duke kontribuar kështu në krijimin e një tregu të integruar dhe konkurrues në rajon.

### 2.2 NJË PASQYRË E PËRGJITHSHME E NIVELIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR AGJENDËN E GJELBËR: DEKARBONIZIMI

NIVELI I ZBATIMIT			
Plani i veprimit	Asnjë	I vogël	Mesatar Transformues
Agjenda e Gjelbër: Dekarbonizimi		✓	

Në dhjetor të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Ndryshimet Klimatike, i cili përputhet pjesërisht me rregulloret dhe direktivat e BE-së për qeverisjen e energjisë dhe klimës. Ky ligj parashikon krijimin e Divizionit për Ndryshimet Klimatike dhe rritjen e numrit të stafit në Ministrinë e Mjedisit, për të përmirësuar efektivitetin në këtë fushë. Ligji gjithashtu kërkon zhvillimin e akteve nënligjore dhe përfshin objektiva të qarta për energjinë e ripërtëritshme, efikasitetin e energjisë dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë deri në vitin 2030. Kosova synon që 32% e konsumit bruto të energjisë të vijë nga burime të ripërtëritshme, dhe që konsumi primar dhe përfundimtar i energjisë të kufizohet në 2.7 dhe 1.8 Mtoe, respektivisht.

Ligji për Promovimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, i miratuar gjithashtu në dhjetor 2023, vendos një objektiv detyrues për energjinë e ripërtëritshme deri në vitin 2030. Ai rregullon ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe krijon mekanizma mbështetës për energjinë elektrike dhe ngrohjen nga burimet e ripërtëritshme. Aktualisht, Kosova është në faza të hershme të zhvillimit të mekanizmave për çmimin e karbonit. Por në aspektin afatgjatë, synon të vendosë një sistem të çmimit të karbonit të harmonizuar me nivelin e çmimeve të EU ETS deri në vitin 2030, në përputhje me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Ndërsa ende janë në pritje të miratimit Projektligjet që kanë mbetur në procedurë që ndërlidhen me aspektin e mjedisit dhe klimës si, Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor dhe Projektligjin për menaxhimin e resurseve ujore. Ndërsa mbeten në plan të hartimit Projektligji i ri për Efiçencën e Energjisë, Projektligji



për Energjinë Elektrike dhe Projektligji për Inspektimin në Fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit.

Strategjia e Kosovës për Energjinë 2022-2031 përmban objektiva konkrete për shpërndarjen dhe konsumimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, përfshirë përpjekjet për të reduktuar emetimet e gazeve serrë me 16.3% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 2016. Kosova ka bërë disa përparime, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike dhe rezidenciale, dhe duke investuar në pajisje dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme. Gjatë këtij viti, Kosova planifikon të hapë ankandin e parë për energjinë e erës me kapacitet 150 MW. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, **Kosova ende përballet me sfida në zbatimin e masave për ndryshimet klimatike dhe ka nevojë për të miratuar një Strategji të Dekarbonizimit, si dhe për të përmirësuar legjislacionin për efizienzën e energjisë në përputhje me direktivat e BE-së. Një Strategji e Përshtatjes Klimatike gjithashtu është e nevojshme për të adresuar sfidat mjedisore dhe klimatike në Kosovë.**

Në përgjithësi, Kosova ka bërë disa hapa të rëndësishëm drejt përafrimit të politikave të saj klimatike me BE-në, por mbeten ende shumë punë për të bërë në aspektin e zhvillimit të mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimit të masave konkrete për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të rritur përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Kosova duhet të përshpejtojë hartimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, duke përfshirë masa konkrete për arritjen e objektivave të energjisë së pastër dhe

reduktimin e emetimeve, sipas standardeve të BE-së. Po ashtu, është e rëndësishme që Kosova të fillojë punën për një Strategji për Përshtatje të Ndryshimeve Klimatike dhe të përditësojë Planin e Veprimit të Strategjisë për Ndryshime Klimatike.

Për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit, Kosova duhet të integrojë zgjidhje të bazuara në natyrë si ripyllëzimi dhe menaxhimi i mbeturinave, të forcojë ligjet mjedisore, dhe të rrisë ndërgjegjësimin publik. Për më tepër, Kosova duhet të vendosë nëse do të harmonizojë çmimin e karbonit me Sistemin e Tregtimit të Emisioneve të BE-së apo të prezantojë masa të veta, duke përfshirë një plan të detajuar për zbatimin dhe monitorimin e këtij sistemi. Në sektorin e energjisë, Kosova duhet të miratojë Projektligjet e reja për Efizienzën e Energjisë dhe Energjinë Elektrike, të hartojë Strategjinë e Dekarbonizimit, dhe të përfundojë miratimin e projektligjeve të tjera që janë në proces. Rishikimi i legjislacionit për mbështetjen e dekarbonizimit dhe zhvillimin e një strategjie për rinovimin e ndërtesave me energji pothuajse zero është gjithashtu thelbësor.

Për sa i përket transportit, Kosova duhet të avancojë projektligjet për hekurudhat dhe të zbatojë Strategjinë e Transportit Multimodal, duke integruar teknologjitë e avancuara dhe zgjidhjet digjitale për menaxhimin e trafikut. Përmirësimi i infrastrukturës dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë janë thelbësore për të mbështetur dhe zgjeruar këto iniciativa.

Në fund, Kosova duhet të angazhohet në mënyrë aktive në Paktin Evropian të Klimës, të avancojë përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe të



## KOSOVA NË PROCESIN E BERLINIT: Deri në çfarë mase janë përmbushur angazhimet për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër?

përshpejtojë eliminimin gradual të qymyrit. Kjo përfshin investime në energjinë e ripërtëritshme, zbatimin e programeve për varfërinë energjetike dhe promovimin e transportit të qëndrueshëm.

Të dhënat e detajuara për secilën pikë të Planit të Veprimit lidhur me Dekarbonizimin janë të paraqitura në Shtojcën 2 të këtij Raporti.

Në bazë të të dhënave të kësaj periudhe, KDI paraqet më poshtë rekomandimet për Kuvendin e Kosovës, duke synuar të fuqizojë rolin e tij mbikëqyrës ndaj Qeverisë, në monitorimin e zbatimit të obligimeve që dalin nga procesi i Berlinit nga Qeveria:

### REKOMANDIME

- Kuvendi i Kosovës duhet të miratojë Projektligjet që kanë mbetur në procedurë që ndërlidhen me aspektin e mjedisit dhe klimës si, Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor dhe Projektligjin për menaxhimin e resurseve ujore. Po ashtu të materializojë iniciativën për Projektligje si Projektligji për Eficiencën e Energjisë, Projektligji për Energjinë Elektrike dhe Projektligji për Inspektimin në Fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit.
- Kuvendi duhet të kërkojë nga Qeveria që të miratojë aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike dhe Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve Ripërtëritëse të Energjisë. Këto akte duhet të adresojnë masat specifike për arritjen e targeteve të reduktimit të emetimeve dhe rritjes së energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2030.
- Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë nga Qeveria që të përshpejtojë finalizimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, duke përfshirë masa konkrete për të arritur objektivat e energjisë së pastër dhe reduktimit të emetimeve, në përputhje me standardet e BE-së.
- Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë nga Qeveria hartimin e një Strategjie për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe të përditësojë Planin e Veprimit të Strategjisë për Ndryshime Klimatike të cilit i ka skaduar afati në vitin 2021.
- Kuvendi i Kosovës të kërkojë nga Qeveria që të angazhohet në mënyrë aktive për të marrë pjesë në Paktin Evropian të Klimës, duke harmonizuar politikat e saj mjedisore me ato të BE-së dhe duke përmirësuar kapacitetet për zbatimin e tyre. Nëse pjesëmarrja e plotë nuk është e mundur, Kosova duhet të krijojë mekanizma kombëtarë dhe të avokojë për mekanizma rajonalë që do të ndihmonin në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përfshirjen e qytetarëve në zgjidhjen e sfidave klimatike.
- Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit për të mbështetur dekarbonizimin e sektorit të energjisë, duke përfshirë edhe kërkesën ndaj Qeverisë që të hartojë Strategjinë e Dekarbonizimit.
- Kuvendi i Kosovës duhet të monitorojë zbatimin e Ligjit për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme.

## SHTOJCA

### 1. Të dhëna të detajuara për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit të Tregut Rajonal: Digjitalizimi

#### TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL – ZONA DIGJITALE RAJONALE

Aktiviteti	Afati kohor	Institucionet përgjegjëse	Ecuria (politikat, aktivitetet)	Hapat vijues
<b>7.1. Infrastruktura digjitale dhe lidhja</b>	2024	Ministria e Ekonomisë	<p>Ministria e Ekonomisë, e mbështetur nga Banka Botërore, po zbaton Programin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE). Përmes këtij programi janë mbështetur me grante kompanitë e sektori privat për të investuar në shtrirjen e internetit në zonat rurale. Të 203 fshatrat, duke përfshirë 105 shkolla dhe 43 qendra të kujdesit shëndetësor, tani kanë internet me lidhje të kablove fibra optik. Që nga mesi i vitit 2022, çdo banor në Kosovë ka qasje në internet.</p> <p>Gjatë 2021- deri në tre mujin e parë të vitit 2024, më shumë se 6 kulla celulare janë lidhur me teknologjinë e fibrave optik për të qenë gat për rrjetet 5G.</p> <p>Numri i përdoruesve celular përmes rrjeteve mobile 4G dhe 5G është në rritje të vazhdueshme, dhe tani depërtimi i qasjes në internet - celular në Kosovë është rreth 100%.<sup>14</sup></p> <p>Raporti i KE-së për Kosovën 2023 gjithashtu ka rikonfirmuar të dhëna të ngjashme.<sup>15</sup></p>	<p>Kosova duhet të rrisë përdorimin e fondeve të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) dhe burimeve të tjera për të avancuar më tutje infrastrukturën digjitale. Gjithashtu të fokusohet në ofrimin e internetit me shpejtësi të paktën 30 Mbps deri në 90% të familjeve dhe të sigurojë që 75% e familjeve të kenë akses në shpejtësi prej të paktën 100 Mbps, me opsionin për të përmirësuar në 1 Gbps.</p>
2. Krijimi i Zyrave të Kompetencës së Internetit të Gjerë (BCO) në Ballkanin Perëndimor (ku ato nuk ekzistojnë) dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të mbështetur qasjen e gjerë në internet	2021	Ministria e Ekonomisë	<p>Zyra Kosovare për Kompetencat me brez të gjerë (BCO) është themeluar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe menaxhon projektin për zgjerimin e infrastrukturës fikse të qasjes së gjerë në internet. BCO e Kosovës ka bashkëpunime dhe merr pjesë në takimet e organizuara nga rrjeti i BCO-ve të BE-së.<sup>16</sup></p>	<p>Qeveria e Kosovës duhet të forcojë Zyren e Kompetencës së Internetit të Gjerë (BCO) duke intensifikuar bashkëpunimin me BCO-të e Bashkimit Evropian për shkëmbim njohurish dhe integrim në rrjetin e BE-së. Plani i Veprimit kërkon rritjen e kapaciteteve të BCO-së dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe integritimit me BCO-së të BE-së.</p>

14 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

15 Komisioni Evropian, Raporti i vendit për Kosovën 2023, fq.69 në, <https://shorturl.at/tDAu>

16 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

3. Ndërlidhja e rrjeteve akademike dhe kërkimore në Ballkanin Perëndimor (BP6), me mbështetjen dhe bashkëpunimin e rrjetit GEANT	2022	Ministria e Ekonomisë	<p>Qëllimi i planit të veprimit ka qenë që deri në vitin 2022 të arrijë ndërlidhjen ndërmjet rrjeteve akademike dhe kërkimore në Ballkanin Perëndimor (BB6) dhe të inkurajojë bashkëpunimin dhe inovacionin rajonal.<sup>17</sup></p> <p>Kosova ka bërë përparim në përmirësimin e lidhjes së rrjetit akademik dhe kërkimor. Projekti KODE themeloi Rrjetin Kosovar të Kërkimit dhe Edukimit (KREN) në vitin 2021, dhe në fund të atij viti, Qendra e tij e të Dhënave u bë funksionale, duke ofruar Microsoft Azure dhe shërbime të tjera për institucionet e arsimit të lartë (IAL). Në vitin 2022, KREN lidhi me sukses të gjitha IAL-të me rrjetin pan-evropian GEANT. Përpjekjet vazhduan në 2023 dhe në fillim të 2024 për të lidhur 100 shkolla filllore dhe të mesme me KREN, me plane për të arritur 220 shkolla deri në fund të 2024. KREN ka krijuar gjithashtu bashkëpunim të fortë me GEANT dhe rrjetet kombëtare rajonale të kërkimit dhe arsimit (NREN).<sup>18</sup></p>	Për tu përmirësuar më tej, Kosova duhet të vazhdojë të zgjerojë rrjetin e KREN-it në më shumë shkolla, të forcojë bashkëpunimin me NREN-të rajonale dhe të promovojë iniciativa që inkurajojnë përparimet teknologjike dhe inovacionin.
4. Zhvillimi i hartës rrugore 5G për Ballkanin Perëndimor (BP6) dhe sigurimi i zbatimit efektiv në përputhje me afatin kohor të përcaktuar	2023	Ministria e Ekonomisë	<p>Në Kosovë, strategjia e Agjendës Digjitale që mbulon periudhën deri në vitin 2030 është miratuar në qershor 2023, e cila përfshin planet për zhvillimin e rrjetit 5G.<sup>19</sup></p> <p>Plani i lëshimit të frekuencave, i miratuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), përfshin brezat kyç të frekuencave për 5G dhe ka ndarë brezat 800 MHz dhe 3.5 GHz për operatorët ekzistues. Që nga fillimi i vitit 2023, mbulimi 5G është i disponueshëm në qendrat e qyteteve dhe deri në vitin 2024/25, rrjeti 5G pritet të mbulojë korridoret kryesore si Morinë-Prishtinë dhe Prishtinë-Hani i Elezit.</p>	Për t'u përafuar më tej me planin e veprimit, Kosova duhet të përmirësojë koordinimin rajonal duke bashkëpunuar më ngushtë me ekonomitë e Ballkanit Perëndimor për të harmonizuar spektrin 5G dhe licencimin. Është thelbësore të sigurohet që të gjitha qytetet kryesore industriale të kenë mbulim 5G dhe të vazhdohet me mbulimin e planifikuar 5G për korridoret kryesore Morinë-Prishtinë dhe Prishtinë-Hani i Elezit deri në fund vitin 2024/25.
5. Ulja e tarifave të Roaming-ut brenda BP6 dhe BE-BP përmes zbatimit të Marrëveshjes së Roamingut të BP-së dhe Udhërrëfyesit për uljen e tarifave të Roamingut midis BE-së dhe BP-së			<p>Kosova ka zbatuar me sukses Marrëveshjen Rajonale për Roaming (MRR) me vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila ka hyrë në fuqi që nga 1 korriku 2021, duke iu përmbajtur kushteve dhe kritereve të marrëveshjes.<sup>20</sup></p> <p>MRR konsiderohet si një nga arritjet më të rëndësishme të Agjendës Digjitale për Ballkanin Perëndimor, si dhe Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor dhe Tregut të Përbashkët Rajonal.<sup>21</sup></p> <p>Edhe Raporti i BE-së për Kosovën i vitit 2023 ka rikonfirmuar se, Kosova është angazhuar në mënyrë konstruktive në dialogun rajonal të nivelit të lartë për transformimin digjital dhe zbatimin e Marrëveshjes Rajonale të Roamingut.<sup>22</sup></p>	Kosova duhet të rishikojë rregullisht efektivitetin e Marrëveshjes Rajonale për Roaming, të punojë në zbatimin e udhërrëfyesit për reduktimin e tarifave të roamingut BE-BB dhe të vazhdojë bashkëpunimin me partnerët rajonalë dhe të BE-së për të përmirësuar dhe zgjeruar marrëveshjet e roamingut. Për më tepër, duhet të komunikojë përfitimet e tarifave të reduktuara të roaming për publikun dhe bizneset për të maksimizuar ndikimin e marrëveshjes.

17 Shih Planin e Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal në, <https://www.rcc.int/docs/543/common-regional-marKomisionit-Evropiant-action-plan>

18 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

19 Shih Agjendën Digjitale të Kosovës 2030 në, <https://arKomisionit-Evropianp-rks.org/desk/inc/media/82582FB3-CD31-4D3D-A2AA-F7CC21ACADCA.pdf>

20 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

21 Shih më shumë për Roamingun në, [https://www.rcc.int/priority\\_areas/53/roaming](https://www.rcc.int/priority_areas/53/roaming)

22 Raporti i BE-së për Kosovën 2023, fq. 69.



## VEPRIMET RAJONALE

5.1. Përfundimi i fazës përfundimtare të Marrëveshjes Rajonale të Roaming	2021	Ministria e Ekonomisë	<p>Plani i Veprimit parashikonte zero tarifa Roaming të shitjes me pakicë brenda BB6 që nga 1 korriku 2021;</p> <p>Qëllimi përfundimtar i MRR-së për të futur regjimin e Roam Like at Home (RLAH) (Roaming si në shtëpi-RSSH) në rajon që nga 1 korriku 2021 u arrit me sukses dhe u krijua rajoni i BB-së pa roaming, që do të thotë se aktualisht, konsumatorët e BP-së nuk paguajnë tarifa shtesë për thirrjet, SMS-të dhe të dhënat celulare gjatë roamingut në rajon, krahasuar me atë që paguajnë në shtëpi.<sup>23</sup> Futja e regjimit të RLAH nga 1 korriku 2021 rezultoi në rritje të konsiderueshme të konsumit/përdoruesit të të gjitha shërbimeve roaming në rajon, duke konfirmuar kështu ndjeshmërinë e lartë të çmimeve të roamerëve të BP.<sup>24</sup></p>	Kosova duhet të monitorojë Marrëveshjen Rajonale për Roaming, të finalizojë dhe zbatojë udhërrëfyesin për reduktimin e mëtejshëm të tarifave të roamingut BE-BB, të përmirësojë koordinimin me partnerët rajonalë dhe të informojë konsumatorët për përfitimet dhe ndryshimet në tarifatat e roamingut.
5.2. Përfundimi i Planit të detajuar për uljen e tarifave të Roamingut midis BE-së dhe BP-së dhe zbatimi efektiv në përputhje me afatin kohor të përcaktuar	2021	Ministria e Ekonomisë	<p>Plani i Veprimit parashikon, uljen e tarifave të roamingut midis BP dhe BE në përputhje me pikat e rëna dakord në Planin e detajuar;</p> <p>Në Samitin BE-Ballkani Perëndimor më 6 dhjetor 2022, 38 operatorë telekomunikacioni nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor nënshkruan një Deklaratë Roaming për të ulur tarifatat e roaming ndërmjet rajoneve duke filluar nga 1 tetori 2023. Marrëveshja do të ulë çmimin maksimal të shitjes me pakicë për 1 gigabajt e të dhënave nga 18 € në 2023 në 14 € në 2026 dhe 9 € në 2028, me rishikime vjetore të planifikuara. Megjithatë, marrëveshjet aktuale vullnetare nuk adresojnë plotësisht nevojat e përdoruesve. Prandaj, reduktime të mëtejshme në çmimet e roaming dhe futja e një modeli RLAH+ janë të nevojshme për të eliminuar përfundimisht plotësisht tarifatat e roaming.<sup>25</sup></p>	Për të avancuar më tej, Kosova duhet të punojë në zvogëlimin e tarifave të roaming. Prezantimi i një modeli RLAH+ gjatë periudhës së tranzicionit do të ndihmojë në sigurimin e politikave më efektive dhe uniforme. Përveç kësaj, Kosova duhet të rishikojë rregullisht ndikimin e këtyre ndryshimeve dhe të përshtatet sipas nevojës, duke promovuar gjithashtu ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe bizneseve për përfitimet e tarifave të reduktuara të roaming.

## 7.2. AFTËSITË DHE KOMPETENCAT DIGJITALE

1. Zhvillimi i strategjive të aftësive digjitale dhe dakordimi për veprime rajonale afatshkurtra dhe afatmesme për përmirësimin e aftësive digjitale	2022-2023	Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	<p>Qeveria e Kosovës miratoi <b>Strategjinë e Arsimit 2022-2026</b> në nëntor 2022 të përgatitur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë. Një nga fushat kryesore të kësaj Strategjie është Edukimi Digjital, i cili përqendrohet në përmirësimin e aftësive digjitale për qytetarët.<sup>26</sup></p> <p>Megjithatë, Raporti i KE-së për vendin 2023 ka thënë se, për zbatimin e suksesshëm, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) duhet të sigurojë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare. Ristrukturimi i MASHTI-t është ende në pritje.<sup>27</sup></p> <p>Në Agjendën Digjitale 2030, "Popullsia me aftësi digjitale" është një nga objektivat e Strategjisë.<sup>28</sup></p>	Kosova duhet të zhvillojë strategji të detajuara të aftësive digjitale, të identifikojë boshllëqet në aftësitë digjitale për grupe të ndryshme dhe të forcojë bashkëpunimin rajonal në veprimet e përmirësimit digjital.
--	-----------	--	---	--

<sup>23</sup> Shih më shumë në, [https://www.rcc.int/priority\\_areas/53/roaming](https://www.rcc.int/priority_areas/53/roaming)

<sup>24</sup> Po aty, fq.30.

<sup>25</sup> Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

<sup>26</sup> Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2022, fq.34.

<sup>27</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.105.

<sup>28</sup> Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2022, fq.34.



<p>2. Krijimi i një depoje kursesh dhe programesh të tjera trajnimi të zhvilluara nga organizata të ndryshme, duke përfshirë MOOC-të me universitete të themeluara, bazuar në analizën e boshllëqeve të Ballkanit Perëndimor dhe nevojat për aftësi digjitale për grupet e synuara</p>	<p>2022-2023</p>	<p>Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</p>	<p>Qëllimi i Planit të Veprimit në këtë drejtim është rritja e aftësive digjitale për grupet e ndryshme. Çdo vit trajnohen të paktën 50 persona.</p> <p>Për të adresuar hendekun e aftësive digjitale, Kosova ka trajnuar mbi 1,500 përfitues përmes projektit IPA të BE-së dhe 900 të rinj të tjerë përmes Projektit KODE të Bankës Botërore, me plane për të arritur në 2,000 deri në fund të vitit 2024. Për më tepër, Ministria e Ekonomisë po mbështet zhvillimin e sektorit të TI-së duke krijuar një Park Teknik në Prishtinë për rritjen e sektorit privat dhe duke krijuar një Qendër Digjitale të Ekselencës në Prizren për të avancuar njohuritë në trendet e reja të TIK-ut si 5G, IoT, AI, të dhëna të mëdha dhe printimi 3D.<sup>29</sup></p>	<p>Zgjerimi i programeve të trajnimit për të arritur më shumë përfitues dhe mbajtja e tyre në linjë me trendet aktuale teknologjike është thelbësore. Për më tepër, rritja e ndërgjegjësimit të publikut për mundësitë e zhvillimit të aftësive digjitale do të ndihmojë në nxitjen e punësimit dhe rritjen ekonomike.</p>
--	------------------	--	---	--

<p>3. Zhvillimi i Planeve të Veprimit për Arsimin Digjital dhe promovimi i barazisë në qasje, veçanërisht për grupet e pafavorizuara dhe pakicat, veçanërisht romët</p>			<p>Plani i Veprimit parashikon veprime të harmonizuara në arsimin digjital në rajon; dhe Standarde të harmonizuara me Kornizën e Kompetencës Digjitale të BE-së; Qeveria e Kosovës në vitin 2022 <b>ka miratuar Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024.</b><sup>30</sup> Megjithatë në këtë Strategji nuk parashihet arsimimi digjital për grupet e pafavorizuara dhe pakicat. Ndërsa as <b>Agjenda Digjitale 2030</b> nuk parasheh ndonjë masë të veçantë për këto grupe. Ngjajshëm ndonjë masë nuk parashihet as me <b>Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023.</b><sup>31</sup></p>	<p>Qeveria e Kosovës duhet të fokusohet në zbatimin e Planeve të Veprimit për Arsimin Digjital në përputhje me iniciativat rajonale dhe standardet e BE-së për të siguruar qasje të barabartë, sidomos për grupet e pafavorizuara dhe pakicat e veçanërisht romët. Zbatimi i Agjendës Digjitale të Kosovës 2030, duke përfshirë strategjitë e përfshirjes për këto grupe do të ndihmojë në arritjen e barazisë digjitale në shoqëri.</p>
---	--	--	--	--

## EKONOMIA DIGJITALE NË EPOKËN E TEKNOLOGJIVE TË REJA TË TIK-UT

<p>1. Organizimi i takimeve të rregullta të nivelit të lartë, duke përfshirë Samitin Vjetor Digjital, për të siguruar që agjenda digjitale të jetë në ballë të transformimit rajonal</p>	<p>Vjetore</p>		<p>Plani i Veprimit parashikon bashkëpunimin e nivelit të lartë qeveri-biznes për sfidat e transformimit digjital të mbajtura përmes Samitit Vjetor digjital;</p> <p>Promovimi i ideve dhe zgjidhjeve digjitale konkurruese dhe inovative bazuar në objektivat/nejat e biznesit të dakorduara në nivel rajonal;</p> <p>Deri më tani ka pasur gjashtë Samite digjitale të mbajtura në vendet e Ballkanit Perëndimor. Samiti i fundit digjital është mbajtur gjatë vitit 2023 në Sarajevë. Ndërsa, Samiti i katërt digjital 2021 i mbajtur në Podgoricë dhe ai i vitit 2022 i mbajtur në Prishtinë, theksuan prioritetet për përmirësimin e mjedisit digjital në Ballkanin Perëndimor për vitin e ardhshëm.<sup>32dhe33</sup></p> <p>Për më tepër, takimet e rregullta ministrore të TIK-ut shërbejnë gjithashtu si një platformë e nivelit të lartë për të adresuar veprimet thelbësore rajonale drejt një rajoni më të mirë të lidhur digjitalisht.<sup>34</sup></p>	<p>Kosova duhet të promovojë ide dhe zgjidhje konkurruese dhe inovative digjitale që përputhen me objektivat e dakorduara me shtetet e rajonit dhe nevojat e biznesit, duke siguruar që këto iniciativa të kenë prioritet dhe të mbështeten në nivel kombëtar dhe rajonal.</p>
--	----------------	--	--	--

29 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

30 Shih Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024 në, <https://shorturl.at/bx1bn>

31 Shih Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023 në, <https://shorturl.at/RUilF>

32 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2021, fq. 15.

33 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2022, fq. 21.

34 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2021, fq. 15.

2. Përafrimi i standardeve për metadata për të dhënat e hapura në nivel rajonal bazuar në standardet e BE-së për t'u zbatuar në të gjithë rajonin dhe për të nxitur parimin e të dhënave të hapura	2023	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	<p>Plani i Veprimit parashikon, aplikimin e standardeve të BE-së për të dhënat e hapura në nivel rajonal;</p> <p>Gjithashtu, mundësohet përdorimi i të dhënave për nevojat dhe hulumtimet qeveritare dhe më të gjera të sektorit publik.</p> <p>Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së administratës shtetërore, Qeveria e Kosovës është duke zbatuar Inicativën për të Dhëna të Hapura, të menaxhuar nga Ministria e Administratës Publike.<sup>35</sup></p>	<p>Siç thuhet edhe në Raportin e Vendit të BE-së 2023, Kosova ende duhet të përafrohet me <i>acquis</i> të BE-së për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.</p> <p>Kosova duhet të punojë në përafrimin e standardeve të saj për të dhëna të hapura, bazuar në standardet e BE-së. Përveç kësaj, Kosova duhet të promovojë përdorimin e të dhënave të hapura për të përmbushur e sektorit të gjerë publik dhe hulumtimit, duke siguruar që të dhënat të jenë të qasshme dhe të përdorshme për këto qëllime.</p>
3. Arritja e një marrëveshjeje për ndërveprimin rajonal të shërbimeve të pagesave në Ballkanin Perëndimor	2022-2024	<p>Ministria e Punëve të Jashtme</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve</p>	<p>Plani i Veprimit parashikon rënien dakord për një sistem të unifikuar pagese në vendet e Ballkanit Perëndimor për të mundësuar udhëtime të pandërprera ndërkufitare.</p> <p>Rruga drejt arritjes së ndërveprimit përfshin konsiderata ligjore, teknike dhe operationale, duke përfshirë pajtueshmërinë me direktivat e BE-së, protokollet e harmonizuara për shkëmbimin e të dhënave dhe vlerësimet e investimeve për përmirësimet e sistemit. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të marrin në konsideratë zbatimin e një qasjeje me faza për të unifikuar sistemet e tyre elektronike të pagesave. Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese dhe përafrimi gradual me standardet e BE-së do të hapë rrugën për ndërveprim të pandërprerë, duke siguruar operatione me kosto efektive dhe duke lehtësuar integrimin rajonal.<sup>36</sup></p> <p>Sa i përket kohës së udhëtimit, sipas Bankës Botërore, “vonesat në pikat e kalimit në Ballkanin Perëndimor janë pesë herë më të gjata se në shumë vende të BE-së dhe kamionët kalojnë rreth 26 milionë orë në pikat e kalimit në rajon çdo vit – kjo është gati 3,000 vjet”.<sup>37</sup>Top of Form</p>	<p>Kosova duhet të punojë drejt krijimit të një sistemi të përbashkët të pagesës së tarifave me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, duke siguruar shkëmbim dhe koordinim të pandërprerë të të dhënave. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e kohës së udhëtimit dhe në përmirësimin e transportit për qytetarët.</p>

35 Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, Open Data në, <https://mpb.rks-gov.net/ap/page.aspx?id=2,33>

36 Raporti i Komunitetit të Transportit, Tolling interoperability in Western Balkans Executive, në <https://www.transport-community.org/wp-content/uploads/2023/04/TC-WB-Interoperability-ExecSummary-202211.pdf>

37 Po aty.

4. Marrëveshje mbi parimet dhe standardet e përdorura për qytetet inteligjente, bazuar në standardet e BE-së, me synimin për të siguruar ndërveprim të dhënave dhe shërbimeve	2023	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunitat	<p>Qëllimi i Planit të Veprimit është të ketë një shkëmbim të përmirësuar të standardeve të aplikuara për shërbimet kryesore, praktikatat më të mira, etj. Gjithashtu të krijohet një rrjet i qyteteve inteligjente në të gjithë Ballkanin Perëndimor.</p> <p>Në këtë drejtim, Projekti “Smart City Kosova” përfshin bashkëpunimin ndërmjet pesë universiteteve nga vende të ndryshme, me qëllim të zhvillimit të një Strategjie Kombëtare për Zhvillim Urban të Zgjuar dhe të Qëndrueshëm dhe strategjive specifike të Smart City për shtatë qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjiilan, Vushtrri dhe Lipjan. Projekti fokusohet në përdorimin e teknologjive digjitale për të përmirësuar shërbimet e qytetit, për të reduktuar emetimet dhe për të përmirësuar lëvizshmërinë urbane dhe hapësirat publike. Ai gjithashtu synon pjesëmarrjen e qytetarëve, vendimmarrjen e mbështetur nga të dhënat dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Projekti është i ndarë në tri faza: mbledhja dhe priorizimi i të dhënave, zhvillimi i strategjisë dhe krijimi i planit të veprimit, me monitorimi i vazhdueshëm për të siguruar zbatimin e suksesshëm.<sup>38</sup></p>	Kosova duhet të harmonizojë iniciativat e saj për qytetet inteligjente me standardet e BE-së për të siguruar ndërveprimin e të dhënave dhe shërbimeve. Përveç kësaj, Kosova duhet të bashkëpunojë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për të ndarë praktikatat më të mira, për të vendosur standarde të përbashkëta dhe për të marrë pjesë në një rrjet rajonal të qyteteve inteligjente.
5. Ndërmarrja e veprimeve rajonale për të promovuar Inteligjencën Artificiale (AI) në aspekte të zgjedhura dhe bazuar në praktikatat e BE-së	2024	Ministria e Ekonomisë	<p>Plani i Veprimit parashikon krijimin e Grupit të Nivelit të Lartë të Ballkanit Perëndimor për Inteligjencën Artificiale (AI); Aspektet e AI të dakorduara në nivel rajonal; Sigurohet plani i veprimit i përgatitur për aspektet e dakorduara; dhe, sinergji me aktivitetet e udhëhequra nga BE për AI;</p> <p>Lidhur me Inteligjencën Artificiale (AI), Ballkani Perëndimor u angazhua të krijojë një Grup Punues rajonal të nivelit të lartë, i cili do të punojë në të gjitha aspektet e AI-së për të siguruar sinergji me BE-në. Kjo u ra dakord në Samitin e 5-të digjital të Ballkanit Perëndimor që u zhvillua në Prishtinë, Kosovë, më 21 dhe 22 shtator 2022.<sup>39</sup> Për t’u përballur më mirë me kërcënimet e sigurisë kibernetike, BP vendosi të përmirësojë bashkëpunimin brenda rajonit, por edhe me BE-në, në veçanti Komisionin Evropian dhe Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike. Qëllimi është rritja e mbrojtjes së infrastrukturës kritike, parandalimi dhe zbulimi i kërcënimeve kibernetike, si dhe zbulimi dhe reagimi efektiv ndaj incidenteve.<sup>40</sup></p> <p>Një studim i Fondacionit SHARE ka zbuluar se vendet e Ballkanit Perëndimor – aktualisht kanë rregulla të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat e epokës digjitale. Legjislacioni ekzistues është shpesh i vjetëruar, i fragmentuar dhe nuk i përmbush standardet evropiane, veçanërisht në menaxhimin e inteligjencës artificiale.<sup>41</sup></p>	Në Maj të vitit 2024, BE ka miratuar një Ligj për Inteligjencën Artificiale. Kjo duhet të shërbejë si shembull për Kosovën dhe vendet e rajonit për të draftuar legjislacionin për AL.

38 Po aty.

39 Faqja zyrtare e BE-së, Ballkani Perëndimor punon së bashku në përmirësimin e transformimit digjital në <https://rb.gy/fbonjt>

40 Po aty.

41 Shih këtë studim në, <https://www.sharefoundation.info/en/digital-ecosystem-of-the-western-balkans-from-regulatory-gap-to-systemic-approach/>

## FUSHAT PRIORITARE: VEPRIMET RAJONALE

6. Ndërmarrja e aktiviteteve rajonale për të lehtësuar pjesëmarrjen e Ballkanit Perëndimor në programet e Bashkimit Evropian për Informatikë me Performancë të Lartë (HPC)	2023-2024	Ministria e Ekonomisë	<p>Plani i Veprimit parashikon që deri në vitin 2024, të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të integrohen me rrjetin informatikë me performancë të lartë të BE-së. Për më tepër, duhet të rritet përdorimi i Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për të mbështetur projektet dhe investimet e HPC-së në rajon.</p> <p>Ndërmarrja e Përbashkët Evropiane për Performancë të Lartë Kompjuterike (Euro PLK) synon të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve evropianë, të avancojë shkencën, të rrisë konkurrencën industriale dhe të sigurojë autonominë teknologjike të Evropës. Është subjekt juridik dhe financimi, i krijuar në vitin 2018 dhe me vendndodhje në Luksemburg. Ai bashkon burimet e Bashkimit Evropian, 32 vendeve evropiane dhe tre partnerëve privatë. Nga Ballkani Perëndimor bëjnë pjesë vetëm Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.<sup>42</sup></p> <p>Deri më sot, Kosova nuk i ka shfrytëzuar shërbimet e ofruara nga Euro HPC. Megjithatë, ka një vlerësim të vazhdueshëm brenda Kosovës në lidhje me miratimin e mundshëm të këtyre shërbimeve në përpjekjet e saj të ardhshme.<sup>43</sup></p> <p>Kriteret për të hyrë në burimet e EuroHPC janë të ngjashme me ato për të hyrë në shërbimet e përgjithshme të HPC. Ato shpesh përfshijnë kërkesat e përshtatshmërisë, një proces aplikimi që përshkruan nevojat kompjuterike, pajtueshmërinë me politikat e përdorimit, demonstrimin e ekspertizës, tarifatat e mundshme dhe menaxhimin e disponueshmërisë së burimeve gjatë kërkesës së lartë. Megjithatë, detajet specifike mund të ndryshojnë në bazë të iniciativës Euro HPC dhe strukturave të saj partnere.</p>	Kosova duhet të marrë pjesë aktivisht në përpjekjet rajonale për t'u integruar me rrjetin kompjuterik me performancë të lartë të BE-së. Përveç kësaj, ajo duhet të rrisë përdorimin e Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor për të siguruar financim dhe investimet e HPC-së, duke siguruar pjesëmarrje efektive në infrastrukturën kompjuterike të BE-së. Top of Form
--	-----------	-----------------------	--	--

42 Faqja zyrtare e BE-së, Ndërmarrja e Përbashkët Evropiane e Informatikës me Performancë të Lartë në, <https://rb.gy/fbonjt>  
43 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë nëntor 2023.

<p>7. Ndërmarrja e aktiviteteve rajonale për të përmirësuar disponueshmërinë, analizën dhe monitorimin e statistikave të ekonomisë digjitale me cilësi të lartë, duke u mbështetur në Indeksin e Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale të BE-së (DESI) dhe Indeksin e Zhvillimit të TIK-ut të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU)</p>	<p>2022</p>	<p>Plani i veprimit fokusohet në monitorimin e konkurrencës digjitale rajonale, identifikimin e fushave prioritare për mbledhjen e të dhënave për matjen e treguesve DESI dhe rritjen e përdorimit të këtyre të dhënave për raportim dhe analizë.</p> <p>Kosova ka një nivel të përgatitjes në fushën e statistikave. Gjatë vitit 2023 është raportuar progres, veçanërisht në përmirësimin e metodologjisë së mbledhjes së të dhënave; transmetimin e të dhënave në Eurostat; dhe zbatimin të rekomandimeve të Eurostat. Komunikimi midis institucioneve të ndryshme statistikore është përmirësuar, por koordinimi në nivel teknik dhe përdorimi i të dhënave administrative në dispozicion janë të pamjaftueshme.<sup>44</sup></p> <p>Disa statistika mbi energjinë, statistikave sociale dhe statistikave afatshkurtra në sektorin e shërbimeve dërgohen në Eurostat në baza mujore, ndërsa ato dikur dërgoheshin në baza tremujore.<sup>45</sup></p> <p>Regjistrimi i popullsisë në Kosovë i realizuar gjatë muajit prill 2024 ofron të dhëna të përditësuara demografike, të cilat do të përmirësojnë përcjelljen e konkurrencës digjitale, do të përmirësojnë mbledhjen e të dhënave DESI dhe do të përmirësojnë saktësinë e raportimit.</p>	<p>Kosova duhet të rrisë numrin e produkteve statistikore që dërgohen në Eurostat. Për të realizuar këtë duhet të rriten kapacitetet e Agjencisë për Statistika të Kosovës.</p>
<p>8. Bashkëpunimi rajonal në lidhje me shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e transformimit digjital, në veçanti E-qeverisjes</p>	<p>Vjetore</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike</p>	<p>Plani i Veprimit parashikon krijimin e partneriteteve të reja dhe të përmirësuara për transformimin digjital dhe zhvillimin e qeverisjes elektronike, me të paktën dy ngjarje rajonale të organizuara çdo vit.</p> <p>Në Kosovë, portali i E-qeverisjes E-Kosova është funksional. Platforma ofron mbi 150 shërbime plotësisht të digjitalizuara.<sup>46</sup> Ka zgjeruar dukshëm gamën e saj të shërbimeve në platformën e-qeverisë dhe ka iniciuar plane për të modernizuar dhe digjitalizuar lejet dhe licencat brenda të njëjtës platformë.<sup>47</sup></p> <p>Gjatë vitit 2023 është miratuar edhe Strategjia e Kosovës për Qeverisje Elektronike 2023- 2027.<sup>48</sup></p>	<p>Kosova duhet të zhvillojë dhe forcojë partneritetet me shtetet e Ballkanit Perëndimor, duke u fokusuar në shkëmbimin e njohurive dhe rritjen e kapaciteteve të ndërsjella për transformimin digjital dhe e-qeverisjen. Kjo do të mbështesë zbatimin efektiv të nismave digjitale dhe zhvillimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike nga e cila përfitojnë qytetarët.</p>

44 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.73.

45 Po aty.

46 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.96.

47 Po aty fq.103.

48 Shih Strategjinë për Qeverisje Elektronike këtu, <https://rb.gy/7h760z>

## 7.4. BESIMI DHE SIGURIA

<p>1. Marrëveshje për standardet dhe specifikimet minimale teknike për të lejuar shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve dhe kryerjen e aktiviteteve pilot</p>	<p>2021 Pilotimi 2022- 2023</p>	<p>Të gjitha institucionet dhe agjencitë</p>	<p>Plani i veprimit parasheh lehtësim të lëvizjes së shërbimeve në gjithë rajonin. Si dhe pilotim të shkëmbimit të të dhënave dhe dokumenteve.</p> <p>Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike, më 6 dhjetor 2021. Në dhjetor 2022 është miratuar një paketë e akteve nënligjore (gjithsej 10 rregullore) të nevojshme për zbatimin e ligjit.</p> <p>Në zbatim të këtij ligji, po zbatohet projekti i financuar nga IPA "Përkrahja e BE-së për dixhitalizimin e bizneseve përmes TIK", në kuadër të të cilit do të krijohet Sistemi eID dhe do të mundësojë zbatimin e identifikimit dhe autentifikimit elektronik. Ky projekt është planifikuar të përfundojë deri në fund të vitit 2024.<sup>49</sup></p> <p>Mirëpo, në Kosovë, cilësia e të dhënave dhe shkëmbimi i të dhënave nëpër agjenci të ndryshme për administrimin e taksave mbeten sfidë.<sup>50</sup></p> <p>Në nivel rajonal, CEFTA Traces NT u lansua në korrik 2022 dhe u pilotua për të mundësuar shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve në lidhje me certifikatat fitosanitare dhe dokumentet e zakonshme në shëndetësi.</p> <p>Versioni i ri i Paketës së Transparencës mbahet në cloud të CEFTA-s dhe sjell përmirësim të ndjeshëm në krahasim me gjendjen e mëparshme. Sistemi përdor teknologjinë më të fundit, është më i sigurt dhe më i fuqishëm dhe më i lehtë për mirëmbajtje. Të gjitha bazat e të dhënave janë përmirësuar në mënyrë funksionale dhe teknike dhe manualët shoqëruese të përdoruesve janë shpërndarë dhe përdoruesit janë trajnuar.<sup>51</sup></p>	<p>Brenda Kosovës, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave duhet të forcohet mes policisë, Administratës Tatimore, Njësisë së Inteligjencës Financiare, Agjencisë së Regjistrimit Kadastral dhe autoriteteve komunale.</p> <p>Kosova duhet të punojë me partnerët rajonalë për të vendosur standarde teknike për shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve dhe të realizojë projekte pilot për të testuar dhe lehtësuar këto procese, duke përmirësuar lëvizjen e shërbimeve në të gjithë rajonin.</p>
<p>2. Përafrimi i veprimeve rajonale për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë në Ballkanin Perëndimor, bazuar në standardet e BE-së</p>	<p>2023</p>	<p>Agjencia për Informim dhe Privatësi</p>	<p>Plani parashikon mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë në mënyrë uniforme në të gjithë rajonin.</p> <p>Ligjet e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale përputhen ngushtë me legjislacionin e BE-së. Agjencia për Informim dhe Privatësi monitoron zbatimin e ligjit. Është forcuar kuadri ligjor me rregullore dhe udhëzime për kontrollorët dhe inspektimet. Pavarësisht kufizimeve në buxhet dhe fuqi punëtore, Agjencia trajton ankesat për qasje në dokumente publike dhe çështjet e mbrojtjes së të dhënave në mënyrë të pavarur dhe efektive.<sup>52</sup></p> <p>Në nivel rajonal një ngjarje e nivelit të lartë për mbrojtjen e të dhënave në Ballkanin Perëndimor dhe Rajonin e Partneritetit Lindor, u organizua në shtator 2023 nga SIGMA dhe organizata të tjera rajonale. Përfaqësues nga 11 vende duke përfshirë edhe 6 vende të BP diskutuan sfidat dhe mundësitë, duke theksuar nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar, dhe rëndësinë e përshtatjes së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave me teknologjitë në zhvillim.<sup>53</sup></p>	<p>Kosova duhet të fuqizojë tutje kapacitetet e Agjencisë për Informim dhe Privatësi përmes rritjes së burimeve dhe fuqisë punëtore, në mënyrë që të rritet efikasiteti i mbrojtjes së të dhënave.</p> <p>Po ashtu, Kosova duhet të punojë me partnerët rajonalë për të siguruar mbrojtje të qëndrueshme të të dhënave në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Kjo përfshin miratimin e rregulloreve në përputhje me BE-në dhe zbatimin e masave uniforme për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë në të gjithë rajonin.</p>

49 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim gjatë muajit maj-qershor 2024.

50 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq. 98.

51 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal 2022, fq.16.

52 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.31.

53 Shih më shumë në, <https://rb.gy/c2zq8e>



<p>3. Zhvillimi i programeve të mentorimit për Ekipet e Reagimit ndaj Incidentit të Sigurisë Kompjuterike të Ballkanit Perëndimor (CSIRT) dhe institucione të tjera si bashkëpunim afatgjatë me CSIRT-të e avancuara dhe partnerë të tjerë</p>	<p>2023</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>	<p>Plani i veprimit kërkon zhvillimin e programeve të mentorimit për CSIRT-të dhe institucionet e Ballkanit Perëndimor për të përmirësuar aftësinë e tyre për të parandaluar, menaxhuar dhe rikuperuar nga kërcënimet kibernetike, në bashkëpunim me CSIRT-të e avancuar dhe partnerët.</p> <p>Në Kosovë, <b>Ligji i Sigurisë Kibernetike</b>, i u miratua nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2023. Gjithashtu, <b>Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2023-2027</b> u miratua në shtator 2023.</p> <p>Ndërsa në mars 2024, u inaugurua Qendra Shtetërore e Trajnimit për Sigurinë Kibernetike, e cila synon rritjen e sigurisë kibernetike përmes trajnimeve të specializuara dhe mbështetjes si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat.<sup>54</sup></p> <p>Një hulumtimi i BIRN-it i realizuar në qershor 2023 nxjerr në pah një rritje të konsiderueshme të sulmeve kibernetike, veçanërisht, në të gjithë Ballkanin nga viti 2020 deri në vitin 2023. Kjo rritje lidhet me përdorimin më të madh të internetit dhe mbështetjen në teknologjitë biometrike dhe të identitetit digjital. Vendet si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Kosova si dhe Serbia janë përballur me kërcënime të shtuara kibernetike. Kosova është përgjigjur duke forcuar kornizën e saj të sigurisë kibernetike. Gjetjet theksojnë nevojën urgjente për rritjen e ndërgjegjësimit publik, përmirësimin e politikave të sigurisë kibernetike dhe bashkëpunimin më të madh rajonal për të adresuar këto kërcënime në zhvillim dhe për të mbrojtur infrastrukturën kritike digjitale.<sup>55</sup></p> <p>Më 16 tetor 2023, gjatë samitit të Procesit të Berlinit në Tiranë, u nënshkrua një traktat për krijimin e Qendrës së Kapaciteteve Kibernetike të Ballkanit Perëndimor (WB3C) si një organizatë ndërkombëtare. Ky veprim synon të rrisë qëndrueshmërinë kibernetike në rajon duke ofruar trajnime dhe nxitur bashkëpunimin për sigurinë kibernetike dhe krimin kibernetik. WB3C, që pritet të jetë funksional deri në vitin 2025, do të bashkojë partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar kapacitetet kibernetike dhe për të forcuar lidhjet midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.<sup>56</sup></p>	<p>Kosova duhet të rrisë sigurinë e saj kibernetike duke bashkëpunuar me vendet e Ballkanit Perëndimor për të forcuar aftësitë e mbrojtjes kibernetike. Kjo përfshin pjesëmarrjen në programe të përbashkëta trajnimi, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe zhvillimin e strategjive rajonale për të trajtuar kërcënimet kibernetike. Krijimi dhe përmirësimi i ekipeve kombëtare të reagimit ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike (CSIRT) dhe pjesëmarrja në programe mentorimi me CSIRT më të avancuara janë thelbësore. Përveç kësaj, Kosova duhet të angazhohet në shkëmbimin dhe koordinimin e rregullt të informacionit me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për të ndërtuar një infrastrukturë më të avancuar të mbrojtjes kibernetike.</p>
--	-------------	--	--	---

54 Shih më shumë në, <https://kryeministri.rks-gov.net/en/blog/the-state-training-center-for-cyber-security-is-inaugurated/>

55 Shih artikullin e BIRN në, <https://rb.gy/nef04z>

56 Shih më shumë në, <https://rb.gy/q3iesb>

<p>4. Forcimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike në rajonin e Ballkanit Perëndimor përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike - ABESK (ENISA)</p>	<p>2021-2024</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>	<p>Plani i veprimit kërkon forcimin e sigurisë kibernetike në Ballkanin Perëndimor përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike (ENISA) duke përmirësuar Ekipet e Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRTs), trajnimin teknik dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit për të mbrojtur infrastrukturën kritike.</p> <p>Në maj të vitit 2023, BE-ja filloi "Programin e Punëve të Brendshme të BE-së në Kosovë", një iniciativë e rëndësishme që synon forcimin e përafritit të sektorëve të punëve të brendshme të Kosovës me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira. Programi synon të adresojë fushat kritike të reformës në Kosovë, duke përfshirë mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe sigurinë kibernetike. Projekti ofron ndihmë për Ministrinë e Punëve të Brendshme në identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike kombëtare dhe evropiane, si dhe mbështetje në zhvillimin e planeve të sigurisë së operatorëve. Dhe synon të përafrojë kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës me standardet e BE-së.<sup>57</sup></p>	<p>Kosova duhet të ketë prioritet zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe, veçanërisht me Serbinë dhe Bosnjen, për të rritur bashkëpunimin rajonal të sigurisë kibernetike. Integrimi në kornizat e sigurisë së BE-së si ENISA dhe pjesëmarrja në iniciativat rajonale gjithëpërfshirëse janë po ashtu thelbësore. Top of Form</p>
<p>5. Rritja e qëndrueshmërisë së hapësirës kibernetike në BP përmes rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit të biznesit në forcimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike në BP</p>	<p>2022-2023</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>	<p>Plani i veprimit ka kërkuar rritjen e përfshirjes së sektorit privat në forcimin e sigurisë kibernetike në Ballkanin Perëndimor. Ai përfshin zhvillimin e modeleve të bashkëpunimit dhe rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe shkëmbimit të njohurive midis bizneseve, specialistëve kibernetikë dhe palëve të tjera të interesuara.</p> <p>Në Kosovë, Ligji i miratuar për sigurinë kibernetike parashikon që Agjencia e Sigurisë Kibernetike, e krijuar me këtë Ligj, do të krijojë një platformë komunikimi me qytetarët dhe bizneset që do të jetë në dispozicion 24/7 për raportimin e incidenteve kibernetike.<sup>58</sup></p> <p>Gjithashtu, komuniteti i bizneseve dhe shoqëria civile do të përfaqësohen në Këshillin Shtetëror për Sigurinë Kibernetike, i cili është një organ i pavarur këshillimor i përbërë nga të gjithë aktorët.<sup>59</sup></p> <p>Lidhur me nivelin rajonal, në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike të Kosovës 2023-2027, parashikohet rritja e pranisë së Kosovës në organizatat dhe forumet ndërkombëtare dhe rajonale për sigurinë kibernetike. Për më tepër, promovimi i bashkëpunimit kombëtar në të gjithë sektorët dhe pozicionimi i Kosovës si një aktor kompetent për bashkëpunim ndërkombëtar në të dy nivelet rajonale dhe globale.<sup>60</sup></p>	<p>Kosova duhet të forcojë angazhimin me bizneset, ekspertët kibernetikë dhe palët e interesuara për të forcuar përpjekjet rajonale të sigurisë kibernetike. Zbatimi i Ligjit të ri në aspekte të sigurisë kibernetike si krijimi i një platformë 24/7 për raportimin e incidenteve kibernetike dhe për të përfshirë sektorin privat dhe shoqërinë civile në Këshillin Shtetëror për sigurinë kibernetike.</p> <p>Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2023-2027, Kosova duhet të rrisë pjesëmarrjen në forumet globale të sigurisë kibernetike dhe për të përforcuar bashkëpunimin në të gjithë sektorët për një prani më të fuqishme ndërkombëtare të sigurisë kibernetike.</p>

57 Faqja zyrtare e BE-së, BE fillon Programin e Punëve të Brendshme të Kosovës për Forcimin e Bashkëpunimit dhe Sundimit të Ligjit në Kosovë, [https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu-launches-kosovo-home-affairs-programme-strengthen-cooperation-and-rule-law-kosovo\\_en?s=321](https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu-launches-kosovo-home-affairs-programme-strengthen-cooperation-and-rule-law-kosovo_en?s=321)

58 Ligji i Kosovës për Sigurinë Kibernetike Komisionit Evropian në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70933>

59 Po aty.

60 Strategjia Kombëtare e Kosovës për Sigurinë Kibernetike 2023-2027 në, <https://shorturl.at/2t0NY>

# SHTOJCË 2

1. Të dhëna të detajuara për zbatimin e Planit të Veprimit të Agjendës së Gjellbër: Dekarbonizimi

Aktiviteti	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Ecuria (politikat, aktivitetet)	Hapat vijues
<b>1. Harmonizimi me Ligjin e BE-së për Klimën me një vizion për arritjen e objektivave të neutralitetit të klimës deri në vitin 2050</b>	2025	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë.	<p>Kjo pikë e Planit të veprimit parashikon përafrimin me Ligjin e BE-së për Klimën, që do të thotë se qëllimi është arritja e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Neutraliteti klimatik nënkupton balancimin e emetimeve të gazeve serrë me heqjen e tyre për të shmangur rritjen e ngrohjes globale.</p> <p>Në muajin dhjetor të vitit 2023 Kuvendi i Kosovës ka miratuar <b>Ligjin për ndryshimet klimatike</b>. Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloret dhe Direktivën e BE-së për Qeverisjen e Energjisë dhe Klimës, monitorimin e emetimeve të gazrave serrë, dhe tregtimin e lejitimeve të emetimeve.<sup>61</sup></p> <p>Rreth nëntë akte nënligjore do të burojnë nga ky ligj, duke përfshirë rregulloret dhe udhëzimet administrative.<sup>62</sup></p> <p>Pas miratimit të këtij ligji, pritet të krijohet Divizioni për Ndryshimet Klimatike në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Për më tepër, ministria synon të rrisë stafin e saj nga një person në katër. Ky hap synon përmirësimin e efektivitetit të ministrisë në këtë fushë specifike.<sup>63</sup></p> <p>Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 2022/02/MC-EnC, Kosovës i janë caktuar targete deri në vitin 2030: për burimet e ripërtërishme, 32% e konsumit bruto final të energjisë; për efikasitetin e energjisë, 2.7 Mtoe për konsum primar dhe 1.8 Mtoe për konsum final; dhe për GHG, -16.3% ose 8.95 MtCO<sub>2</sub>eq krahasuar me vitin 2016.</p> <p>Kosova ka miratuar <b>Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve Ripërtëruese të Energjisë</b>, që vendos një target të detyrueshëm për përqindjen e energjisë nga këto burime deri në vitin 2030, përcakton përgjegjësitë dhe procedurat administrative për energjinë e ripërtërishme, rregullon ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe mekanizmat për mbështetje, parashikon një skemë mbështetëse për energjinë elektrike dhe ngrohjen/ftohjen nga burimet e ripërtërishme, përcakton qasjen në rrjet dhe nxitë prodhimin dhe shkrirjen e energjisë elektrike nga këto burime, si dhe cakton kriteret e qëndrueshmërisë dhe kursimit të emetimeve nga bio-karburantet, bio-lëngjet dhe biomasa.</p>	Kosova duhet të miratojë akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e <b>Ligjit për Ndryshimet Klimatike</b> dhe <b>Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve Ripërtëruese të Energjisë</b> . Këto akte duhet të adresojnë masat specifike për të arritur targetet e reduktimit të emetimeve dhe rritjes së energjisë së ripërtërishme deri në vitin 2030.

61 Shih Ligjin në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85112>

62 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 24 nëntor 2023, Prishtinë.

63 Po aty.

<b>Vendosja e qëllimeve të energjisë dhe klimës deri në vitin 2030</b>	2022	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë	<p>Në Strategjinë e Kosovës për Energjinë 2022-2031, thuhet se, në kuptimin afatgjatë, Kosova është e përkushtuar që të vendos një sistem të çmimit të karbonit dhe ta harmonizojë atë me nivelet e çmimeve EU ETS deri në vitin 2030, për shkak të nënshkrimit të Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.<sup>64</sup></p> <p>Disa nga objektivat konkrete janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Shpërndarja <b>dhe konsumi i energjisë nga burimet e ripërtitshme synohet që deri në vitin 2030 të jetë 32%</b>.</li> <li>Objektivi i Kosovës në këtë aspekt është më i ulëti krahasuar me objektivat e vendosura nga vendet e tjera të rajonit.<sup>65</sup></li> <li>-<b>Pjesa maksimale e konsumit të energjisë primare (energji primare në Kosovë rrjedh nga qymyri) deri në vitin 2030 synon të jetë 2.70 Mto</b> (milion ton naftë ekuivalente).<sup>66</sup></li> <li>- <b>Pjesa maksimale e konsumit përfundimtar të energjisë në vitin 2030 synohet të jetë 1.80 Mto</b> (milion ton naftë ekuivalente).</li> <li>- <b>Synimi i Kosovës për emetimet e gazrave serrë në krahasim me nivelet e vitit 2016</b> dhe emetimet absolute në vitin 2030 synon të reduktohet me 16.3%. Ky objektivi është më i ulëti në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Përveç kësaj, qëllimi është të emetohen vetëm 8.95 MtCO<sub>2</sub> (milion tonë metrikë) gazra serrë në vitin 2030, që është më i lartë krahasuar, për shembull, me Malin e Zi dhe Maqedoninë që synojnë të lëshojnë vetëm rreth 2 MtCO<sub>2</sub>.<sup>67</sup></li> </ul>
<b>3. Krijimi dhe zbatimi i Planeve të Integruara të Energjisë dhe Klimës</b>	2022	Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	<p>Me miratimin e Rregullores së Qeverisjes në Këshillin Ministror i Komunitetit të Energjisë 2021, zhvillimi dhe miratimi i Planeve të Integruara Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (PIKEK) u bë një detyrim ligjor për Kosovën dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. PIKEK-ët janë një instrument i rëndësishëm për drejtimin e tranzicionit energjetik, përcaktimin e qëllimeve energjetike dhe klimatike të ekonomisë, si dhe politikën dhe masat për arritjen e tyre. Sipas Rregullores, draftet e PIKEK-ve duhet të paraqiten për shqyrtimin dhe opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë deri në qershor 2023 dhe të miratohen deri në qershor 2024.<sup>68</sup></p> <p>Kosova ende nuk ka përfunduar <b>Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën</b> i cili ka filluar të hartohet që nga viti 2018. I njëjti është dërguar zyrtarisht për komentim në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë më 12 korrik 2023. Më 29 dhjetor 2023, SKE dërgoi komentet për draftin e PKEK-së, dhe nga 25-27 mars 2024 u mbajt një punëtori për rishikimin e tyre. Ekspertët e GIZ dhe GET kanë përpunuar këto komente në draftin e dokumentit. Në maj 2024, drafti do të diskutohet publikisht dhe pritet të miratohet nga Qeveria e Kosovës deri në fund të qershorit 2024.<sup>69</sup></p> <p>Kosova duhet të përshpejtojë hartimin e <b>Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën</b>, duke përfshirë masa konkrete për të arritur objektivat e energjisë së pastër dhe reduktimit të emetimeve, në përputhje me standardet e BE-së.</p>

64 Shih Strategjinë e Kosovës për Energji, fq.16, në <https://shorturl.at/RR96y>

65 Faqja zyrtare e UNDP-së në, <https://climatepromise.undp.org/what-we-do/where-we-work/kosovo>

66 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR), Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjellbër 2022, fq.10 në, <https://shorturl.at/9swvD>

67 Po aty.

68 Po aty, fq.12.

69 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në maj-qershor 2024.

<b>4. Përgatitja dhe zbatimi i strategji të ndryshimeve klimatike</b>	2028	Qeveria me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	<b>Një Strategji e Përshtatjes Klimatike nuk është miratuar ende në Kosovë.</b> Puna e hartimit pritej të fillonte në gjysmën e dytë të vitit 2024. <sup>70</sup> Megjithatë, ekzistojnë dokumente të përcaktuara që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike. Në shkurt 2019, Qeveria e Kosovës në atë kohë miratoi <b>Strategjinë për Ndryshimet Klimatike 2019-2028 dhe Planin e Veprimit 2019-2021</b> , i cili tashmë duhet të përditësohet. <sup>71</sup>	Kosva duhet të fillojë të punojë në një hartimin e një Strategjie për Përshtatje të ndryshimeve Klimatike.  Po ashtu, duhet të përditësohet Plani i Veprimit të Strategjisë për Ndryshime Klimatike.
<b>5. Harmonizimi me Sistemin e BE-së për Tregtimin dhe/ose futjen e instrumenteve të tjera të çmimit të karbonit</b>	2024	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	<b>Instrumentet e çmimit të karbonit nuk janë futur ende në rajonin e Ballkanit Perëndimor</b> , me përjashtim të Malit të Zi. <sup>72</sup> Prandaj, Kosova ende nuk ka krijuar një kornizë për mekanizmat e çmimeve të karbonit. Megjithatë, zhvillimi i këtyre skemave të çmimeve të karbonit aktualisht është duke u zhvilluar, mbështetur nga Komuniteti i Energjisë i BE-së. <sup>73</sup> Çmimi i karbonit është thelbësor për veprimin ndaj klimës dhe rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Ai mund të reduktojë emetimet dhe tërheqë investime të pastra. Një qasje e koordinuar rajonale dhe zbatimi i kujdesshëm janë të rëndësishëm për të shmangur disavantazhet tregtare dhe për të siguruar politika efektive ndaj klimës. <sup>74</sup>	Kosova duhet të vendosë nëse do të harmonizojë çmimin e saj të karbonit me Sistemin e Tregtimit të Emisioneve të BE-së (ETS) apo të prezantojë masat e veta të çmimit të karbonit. Hapat e ardhshëm duhet të përfshijnë finalizimin e vendimit për çmimin e karbonit, fillimin e diskutimeve mbi politikat dhe zhvillimin e një plani të detajuar zbatimi me fokus në monitorimin dhe menaxhimin e sistemit të ri.
<b>6. Rritja e mundësive për krijimin e zgjidhjeve natyrore për zbutjen dhe adaptimin e ndryshimeve klimatike</b>	2025	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë	Zbatimi i qasjeve që integrojnë ekosistemet dhe natyrën më gjerësisht në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe masat për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë është ende i pamjaftueshëm dhe i fragmentuar në të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. <sup>75</sup> Kosova është në faza të hershme në adresimin e sfidave mjedisore dhe klimatike, duke bërë progres të kufizuar në ligjet dhe strategjitë për menaxhimin e mbeturinave, cilësinë e ajrit dhe ujit dhe mbrojtjen e natyrës. Për t'u përmirësuar, Kosova duhet të integrojë zgjidhje të bazuara në natyrë, siç është rritja e riciklimit të mbeturinave, mbjellja e pemëve për të përmirësuar cilësinë e ajrit, menaxhimi i ujit, mbrojtja e habitateve natyrore dhe përdorimi i infrastrukturës së gjelbër për të adresuar ndotjen industriale. Këto zgjidhje mund të mbështesin strategjinë e Kosovës për klimën duke reduktuar emetimet e karbonit dhe duke rritur elasticitetin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. <sup>76</sup> Në këtë drejtim, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës po zbaton një projekt të quajtur ADAPT në të gjitha vendet e rajonit. Ky projekt përdor zgjidhje të bazuara në natyrë për të rritur elasticitetin ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor. Ai synon të risë ndërgjegjësimin, të integrojë këto zgjidhje në politika dhe t'i zbatojë ato për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Duke filluar nga nëntori 2019 deri në tetor 2024 me një buxhet 2.48 milionë euro, projekti zbaton partneritete rajonale dhe lokale. <sup>77</sup>	Kosova duhet të fokusohet në integrimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë në politikat klimatike, si ripyllëzimi dhe përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave. Forcimi i ligjeve mjedisore, rritja e ndërgjegjësimit dhe investimi në sistemet e monitorimit janë thelbësore. Bashkëpunimi me partnerët rajonalë dhe zhvillimi i një plani strategjik veprimi do të ndihmojë në sigurimin e zbatimit efektiv.

70 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 24 nëntor 2023, Prishtinë.  
71 Republika e Kosovës, "Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit 2019-2021" në, <https://shorturl.at/r8uY9>  
72 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjelbër 2022, fq.13.  
73 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 24 nëntor 2023, Prishtinë.  
74 Shih publikimin e Bankës Botërore "Raporti për Klimën dhe Zhvillimin e Shtetit 2024", qershor 2024 në, <https://shorturl.at/4APp1>  
75 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjelbër 2022, fq.14.  
76 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.112-117.  
77 Shih më shumë rreth projektit ADAPT në, <https://shorturl.at/VNPaK>



<p><b>7. Garantim i pjesëmarrjes së ekonomive të BP-së në Paktin Evropian të Klimës apo të konsiderohet krijimi i mekanizmave të ngjashëm.</b></p>	<p>2022</p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p><b>Pakti Evropian për Klimën</b> është një nismë e Bashkimit Evropian që synon të angazhojë qytetarët, komunitetet dhe organizatat në veprime konkrete për të luftuar ndryshimet klimatike. Ai promovon ndërgjegjësimin, ndan informacione dhe inkurajon pjesëmarrjen e gjerë për të arritur objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.</p>	<p>Kosova duhet të angazhohet në mënyrë aktive për të marrë pjesë në Paktin Evropian të Klimës, duke harmonizuar politikat e saj mjedisore me ato të BE-së dhe duke përmirësuar kapacitetet për zbatimin e tyre. Nëse pjesëmarrja e plotë nuk është e mundur, Kosova duhet të konsiderojë krijimin e mekanizmave të ngjashëm kombëtarë dhe të avokojë për krijimin e mekanizmave të tillë rajonal që do të ndihmonin në rritjen e ndërgjegjësimit publik, përfshirjen e qytetarëve dhe sektorëve të ndryshëm në zgjidhjen e sfidave klimatike, dhe përmbushjen e objektivave të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.</p>
<p><b>Shqyrtim dhe rishikim, kur është e nevojshme, i të gjitha rregullorëve përkatëse për të mbështetur dekarbonizimin gradual të sektorit të energjisë.</b></p>	<p>Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Megjithëse dekarbonizimi parashikohet në Strategjinë e re të Energjisë të miratuar në mars 2023, <b>Qeveria e Kosovës ende nuk ka hartuar një Strategji të Dekarbonizimit</b>, e cila është përmendur si mangësi edhe në Raportin e KE-së për Kosovën 2023.<sup>78</sup></p> <p>Përpjekjet e Kosovës për të reformuar tregun e saj të energjisë elektrike përballen me shqetësime rreth sigurimit të një furnizimi të sigurt me energji elektrike. Ndërsa ka pasur disa përmirësime në likuiditetin dhe konkurrencën e tregut, performanca mjedisore e Kosovës ka hyrë në regres. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka evidentuar raste të vazhdueshme të shkeljeve për shkak të mungesës së legjislacionit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe shkeljeve të kufijve të emetimeve në impiantet e mëdha të djegies.<sup>79</sup></p> <p>Sa i përket rishikimit të legjislacionit, <b>Projektligji për Energjinë dhe Projektligji për Energjinë Elektrike</b>, kanë kaluar procesin e diskutimit paraprak, publik dhe komentimin nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Projektligji për Energjinë parasheh edhe balancimin politikave në situata me varfëri energjetike.</p> <p>Gjithashtu janë në proces të përgatitjes edhe <b>Projektligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Projektligji për Efiçencën e Energjisë</b>.</p>	<p>Kosova duhet të përshpejtojë rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit të saj për të mbështetur dekarbonizimin e sektorit të energjisë. Kjo përfshin <b>përfundimin dhe miratimin e Strategjisë së Dekarbonizimit</b>. Për më tepër, duhet të përfundojë miratimin e projektligjeve në proces, si ai për energjinë, energjinë elektrike, rregullatorin e energjisë dhe efiçencën energjetike.</p>	

78 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.116.

79 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjelbër, fq. 20.



<p><b>9. Prgatitja e vlerësimit të ndikimit socio-ekonomik të dekarbonizimit në nivelin e ekonomive individuale dhe në nivel rajonal</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë</p>	<p>Kosova ka miratuar Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis në dhjetor të vitit 2022. Ndërsa, ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor ka filluar të vlerësojë ndikimin socio-ekonomik të dekarbonizimit në nivel ekonomik individual përmes një projekti të mbështetur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Qëllimi është që përfundimisht të zhvillohet një plan veprimi që do të përfshijë rekomandime për reformat e kërkuara të politikave për të adresuar këtë çështje.<sup>80</sup></p>	<p>Kosova duhet të kryejë një vlerësim të plotë të ndikimit socio-ekonomik të dekarbonizimit, duke analizuar efektet në nivel kombëtar dhe rajonal. Ky vlerësim do të ndihmojë në krijimin e strategjive të përshtatshme për të minimizuar ndikimet negative dhe për të maksimizuar përfitimet nga tranzicioni drejt një ekonomie me karbon të ulët.</p>
<p><b>Prioritizimi i efikasitetit të energjisë dhe përmirësimit të saj në të gjithë sektorët</b></p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Kosova ka bërë disa përpjekje, veçanërisht me miratimin e një Strategjie të re ambicioze të Energjisë në mars 2023, lansimin e ankandit të parë diellor në maj 2023, dhe me investime të mëtejshme në efikasitetin energjetik të ndërtesave publike dhe rezidenciale në përputhje me planin e veprimit të Paketës së Mbështetjes së Energjisë.<sup>81</sup> Ky ankand ka përfunduar gjatë vitit 2024 dhe kompania fituese është përzgjedhur.<sup>82</sup></p> <p>Po ashtu në muajin maj 2024, është miratuar <b>Ligji për performancën energjetike të ndërtesave</b>.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vitit 2024, Kosova pritet të hapë ankandin e parë për energjinë e erës me kapacitet 150 MW.<sup>83</sup></p> <p>Në kuadër të Strategjisë së Energjisë, rritja e efikasitetit të energjisë synon kufizimin e konsumit të energjisë në 1877 ktoe deri në vitin 2031. Aktualisht, po zbatohen masa të efikasitetit në 12 objekte publike, me projekte që përfundojnë në qershor dhe dhjetor 2024, me një investim total prej mbi 2 milionë euro.<sup>84</sup></p>	<p>Kosova duhet të miratojë Projektligjet e reja si <b>Projektligjin për Efikasitet të Energjisë, Projektligjin për Energji dhe Projektligjin për Energjinë Elektrike</b>, për të siguruar efikasitetin e energjisë në të gjithë sektorët.</p> <p>Tutje, Kosova duhet të mobilizojë më shumë financime dhe të forcojë kapacitetet e institucioneve për të zbatuar dhe monitoruar kursimet. <b>Projektligji për efikasitetin e energjisë dhe Ligji për performancën energjetike të ndërtesave</b> duhet të përfrohen me direktivat e reja siç kërkohet nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.</p> <p>Sipas ligjit në fuqi, Kosova duhet të zbatojë certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave dhe të miratojë Strategjinë e Rinovimit të Ndërtesave dhe Planin për ndërtesat me energji pothuajse zero.</p>
<p><b>11. Transpozimi dhe zbatimi i plotë i Direktivës për Performancën Energjetike të Ndërtesave</b></p>	<p>2023</p>	<p>Ministria e Ekonomisë</p> <p>Siç u cek më lartë, në maj 2024, Kosova ka miratuar <b>Ligjin për performancën energjetike të ndërtesave. Mirëpo në tekstin e ligjit thuhet se:</b> Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2010/31/BE për Performancën Energjetike të Ndërtesave dhe Direktivën (BE) 2018/844 që e Ndryshon Direktivën 2010/31/BE për Performancën Energjetike të Ndërtesave.<sup>85</sup> Në anën tjetër duhet të ndryshohet, <b>Ligji për Efikasitetin e Energjisë</b> i miratuar në vitin 2018, për tu përfaqësuar me direktivat e reja të BE-së siç kërkohet nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.<sup>86</sup> Aktivitetet për të forcuar ekspertizën dhe mjetet për certifikimin e ndërtesave janë në vazhdimësi, duke përfshirë regjistrin e ri dhe softuerin e certifikimit.<sup>87</sup> Megjithatë, <b>Strategjia e Rinovimit të Ndërtesave dhe Plani për ndërtesat me energji gati zero</b> ende nuk janë miratuar.<sup>88</sup></p>	<p>Kosova duhet të përditësojë <b>Ligjin e saj për Efikasitetin e Energjisë</b> të vitit 2018 që të përputhet me standardet e BE-së, të finalizojë strategjinë e saj për rinovimin e ndërtesave dhe planin e ndërtesave me energji pothuajse zero, dhe të kompletojë regjistrin e ri dhe softuerin e certifikimit për ndërtesat. Zbatimi dhe monitorimi i zgjeruar nevojiten gjithashtu për të siguruar përputhjen me standardet e performancës së energjisë.</p>

80 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 24 nëntor 2023, Prishtinë.

81 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.110.

82 Shih më shumë në, <https://shorturl.at/GeWbE>

83 Balkan Green Energy, faqja zyrtare në internet, <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-to-hold-its-first-wind-power-auction-in-2024/>.

84 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim gjatë muajit maj-qershor 2024.

85 Shih Ligjin, Nenin 1 në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=92131>

86 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq. 113.

87 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjellbër 2022, fq.24.

88 Po aty.

<p><b>12. Mbështetja e programeve për rinovimin e ndërtesave private dhe publike dhe sigurimi i fondeve të përshtatshme</b></p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Ministria e Ekonomisë</p>	<p>Edhe gjatë vitit 2024 Kosova ka vazhduar me projektet e renovimit për ndërtesat residenciale dhe publike me mbështetje nga qeveria dhe donatorët. Nga janari deri në maj, Fondi për Eficiencën e Energjisë ka përfunduar auditimet dhe projektet për 35 ndërtesa publike dhe ka paguar për 1,110 shtëpi rezidenciale. Ndërsa, po vazhdon auditimi për gjashtë ndërtesa shumë banesore. Investimet synojnë të reduktojnë përdorimin e energjisë deri në 70%.</p> <p>Janë investuar 35 milion euro në sektorin residencial dhe në bizneset për pajisje efikase dhe sisteme të energjisë ripërtëritshme. Thirrjet publike për mbështetje në sistemet fotovoltaike janë të hapura deri në nëntor 2024. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë marrë 5 milion euro për ngrohje efikase dhe energji ripërtëritshme.<sup>89</sup></p>	<p>Kosova duhet të vazhdojë tutje me programet për rinovimin e ndërtesave private dhe publike. Në këtë drejtim duhet të sigurojë financim të mjaftueshëm dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e këtyre programeve.</p>
<p><b>13. Rritja e pjesës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe krijimi i kushteve të nevojshme të investimit</b></p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Ministria e Ekonomisë</p>	<p>Kosova iu afrua përbushjes së objektivit të saj të vitit 2020 për përdorimin e energjisë së ripërtëritshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë. Objektiva të reja janë miratuar nga Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022.<sup>90</sup></p> <p>Kosova ka avancuar ndjeshëm në rritjen e kapaciteteve për burimet e ripërtëritshme të energjisë. <b>Në maj 2023, u zhvillua ankandi i parë solar fotovoltaik me kapacitet 100 MW</b>, ku konsorciumi “Orllati” fitoi me çmimin 48.88€/MWh.</p> <p>Pas këtij ankandi, <b>planifikohet një ankand tjetër për energjinë e erës me kapacitet 150 MW</b>, për të cilin është nënshkruar një marrëveshje me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC).</p> <p>Projekte të tjera në zhvillim përfshijnë një central solar 100 MW në KEK dhe një projekt për furnizim me energji termike nga energjia diellore me kapacitet 50 MW, të cilët janë në proces vlerësimi dhe aplikimi për financim.</p> <p>Po ashtu, është në zhvillim një projekt për ndërtimin e një sistemi të ruajtjes së energjisë me bateri 170 MW, me një marrëveshje të bashkëfinancimit të nënshkruar më 13 mars 2024 dhe themelimin e Korporatës së Ruajtjes së Energjisë.<sup>91</sup></p>	<p>Kosova duhet të zbatojë <b>Ligjin e sapo miratuar për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.</b></p> <p>Po ashtu, për të përbushur më tej kërkesat e planit për të rritur përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe për të krijuar kushte të nevojshme për investime, Kosova duhet të përshpejtojë zbatimin e projekteve ekzistuese, të sigurojë financim dhe mbështetje të mëtijshme për projekte të reja, të investojë në modernizimin e infrastrukturës energjetike, të forcojë politikën dhe rregulloret për energjinë ripërtëritshme, dhe të promovojë pjesëmarrjen e gjerë dhe edukimin në këtë sektor.</p>

89 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim gjatë muajit maj-qershor 2024.

90 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raportin i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër 2022, fq.26.

91 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim gjatë muajit maj-qershor 2024.

<p><b>14. Zvogëlimi dhe eleminimi gradual i subvencioneve të qymyrit, në përputhje të plotë me rregullat e ndihmës shtetërore.</b></p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p><b>Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë mbështetet shumë në termocentralet me qymyr.</b> Më shumë se 90% e energjisë elektrike prodhohet nga dy termocentrale të vjetruara, jo të besueshme dhe shumë ndotëse të linjtit, të cilat qeveria planifikon t'i rinovojë.<sup>92</sup></p> <p><b>Strategjia e Energjisë</b> parashikon zëvendësimin gradual të përdorimit të qymyrit deri në vitin 2050, nëpërmjet tre objektivave strategjike a) uljen graduale të çmimit të karbonit, b) nxitjen e energjisë së ripërtëritshme në përzierjen e prodhimit të energjisë elektrike, c) nxitjen e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje.<sup>93</sup></p> <p>Në vitin 2022, Kosova prezantoi për herë të parë subvencione për investime në burime më efikase dhe më pak ndotëse, gjë që u pa si një pikë kthese e mirë.<sup>94</sup> Që nga viti 2012, Kosova nuk ofron subvencione për qymyr. Ndërsa, përdorimi i qymyrit është i ndaluar vetëm në institucionet shkollore dhe shtëpiake.<sup>95</sup> Megjithatë, qymyri vazhdon të përdoret për qëllime ngrohjeje.</p>	<p>Kosova duhet të përshpejtojë eliminimin gradual të qymyrit, duke vendosur afate konkrete deri në vitin 2050. Kjo përfshin investime në rinovimin e termocentraleve dhe rritjen e burimeve të energjisë së ripërtëritshme.</p>
<p><b>15. Garantimi i pjesëmarrjes në Nismën për Mbështetjen e Rajoneve të Qymyrit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor</b></p>	<p>Ministria e Ekonomisë</p>	<p>“Iniciativa për Rajonet e Qymyrit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë” (2020-2023) ka synuar të ndihmojë rajonet e varura nga qymyri në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Ukrainë në kalimin drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit. E menaxhuar nga Komisioni Evropian dhe partnerët, ajo ka ofruar dialog rajonal, ngritje kapacitetesh dhe asistencë teknike. Iniciativa mbështeti objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane për neutralitet klimatik, me një përpjekje të re të planifikuar për vitin 2024 për të vazhduar këto veprime në Ballkanin Perëndimor.<sup>96</sup></p>		

92 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.68.

93 Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës, fq. 8.

94 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq. 115.

95 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, 27 nëntor 2023, Prishtinë.

96 Shih më shumë në, <https://shorturl.at/xH1jj>

<p><b>16. Zhvillimi i programeve për të adresuar problemin e varfërisë energjetike dhe financimin e skemave për rindërtimin e familjeve dhe sigurimin e standardeve themelore të jetesës</b></p>	<p>Ministria e Ekonomisë</p>	<p>Nivelet e varfërisë energjetike në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë ndër më të lartat në Evropë. Varfëria energjetike ndodh kur një familje duhet të zvogëlojë konsumin e saj të energjisë në një shkallë që ndikon negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve. Sipas EUROSTAT, pjesa e familjeve në Komunitetin e Energjisë të paafta për të mbajtur shtëpitë në mënyrë adekuate të ngrohta është shumë më e lartë se mesatarja e BE-së, me nivelet më të larta në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, e ndjekur nga Mali i Zi dhe Serbia.<sup>97</sup></p> <p>Sipas një publikimi të GIZ, të vitit 2023, varfëria energjetike në Kosovë është një problem i madh që prek rreth 40% të familjeve, veçanërisht ato me të ardhura të ulëta, sidomos komunitetet Roma, Ashkali, dhe Egjiptian. Familjet në varfëri energjetike shpenzojnë një pjesë të madhe të të ardhurave për energji, dhe shpesh nuk kanë mundësi të paguajnë faturat ose të ngrohin shtëpitë gjatë dimrit. Ndërkohë që ligjet aktuale përfshijnë disa masa për të mbrojtur konsumatorët në nevojë, ato ende nuk janë të mjaftueshme për të adresuar rritjen e kostove të energjisë dhe për të përmirësuar standardet e jetesës dhe shëndetit të qytetarëve.<sup>98</sup></p> <p>Të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, tashmë kanë zbatuar disa masa afatshkurtra që synojnë zbutjen e varfërisë energjetike.<sup>99</sup> Edhe pse efektive në planin afatshkurtër, ato rezultojnë të pamjaftueshme për zbutjen afatgjatë të varfërisë energjetike.</p> <p>Top of Form</p> <p>Për më tepër, Paketa e re e Mbështetjes së Energjisë e BE-së, me vlerë 1 miliard euro në grante, ishte një rezultat i rëndësishëm i Deklaratës së Tiranës.<sup>100</sup> Sipas kësaj pakete dhe nëpërmjet IPA III, BE-ja siguroi <b>500 milionë euro</b> grante për mbështetje të menjëhershme për familjet në nevojë.<sup>101</sup></p> <p>Duke filluar nga viti 2022, Kosova filloi projekte në dy faza për të financuar subvencionimin e pajisjeve me efikasitet energjetik për familjet. Kjo iniciativë synon të zvogëlojë drejtpërdrejt kërkesën për energji duke siguruar një subvencion prej 40% për këto blerje.<sup>102</sup></p> <p>Në janar të vitit 2024 Ministria e Financave ka njoftuar që ka nisur <b>subvencionimi i energjisë elektrike</b> për familjet e cënueshme i mbështetur nga BE, nga i cili do të përfitojnë 40,620 familje.<sup>103</sup></p>	<p>Kosova duhet të përshpejtojë zbatimin e programit të varfërisë energjetike dhe të krijojë skema financiare për rinovimin e banesave për familjet me të ardhura të ulëta. Subvencionet për pajisjet energjetike duhet të zgjerohen, ndërsa ndërgjegjësimi për eficiencën energjetike duhet të forcohet. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë duhet të intensifikohet për të siguruar mbështetje për këto masa dhe për të përmirësuar standardet e jetesës.</p>
--	------------------------------	---	---

97 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Agjenda e Gjellbër për Raportin e Zbatimit të Planit të Veprimit të BP 2022, fq.32.

98 Shih më shumë në, <https://www.giz.de/en/downloads/giz2023-en-factsheet-energy-poverty.pdf>

99 Po aty, fq.32.

100 Samiti BE-Ballkani Perëndimor, Deklarata e Tiranës, 6 dhjetor 2022.

101 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër 2022, fq.32.

102 Ministria e Ekonomisë, faqja zyrtare në, <https://me.rks-gov.net/blog/zgjatet-afati-i-aplikimit-per-fazen-1-per-subvencionim-te-eficiences-se-energjiise/>

103 Shih më shumë në Ministria e Financave, faqja zyrtare në Facebook në <https://shorturl.at/jzegb>

<p><b>17. Mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës inteligjente, promovimi i nxitjes së teknologjive novatore (si transporti pa bileta, inteligjenca artificiale, bileta multimodale e pasagjerit, lëvizshmëria si shërbim, aplikacionet e kalimit kufitar të kufirit, korridoret 5G, etj)</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë</p>	<p>Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Transportit ka ofruar asistencë teknike në lidhje me vendosjen e mallrave elektronike në Ballkanin Perëndimor që synon të mundësojë një sistem ndërveprues të shkëmbimit të informacionit elektronik të mallrave në rajon, duke zvogëluar barrën administrative për operatorët e logjistikës dhe duke lehtësuar transportin multimodal.<sup>104</sup></p> <p>Kuadri legjislativ për vendosjen e Sistemit Evropian për Menaxhim të Trafikut Hekurudhor (SEMTH) u bë nga të gjitha ekonomitë e BP-së, përfshirë Kosovën.<sup>105</sup></p> <p>Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po përmirëson sistemin e transportit urban në Prishtinë duke siguruar një kredi të lartë deri në 10 milionë euro në kuadrin e Qyteteve të Gjellbra. Projekti do të prezantojë për herë të parë teknologjinë e autobusëve elektrikë në Kosovë, me gjashtë autobusët elektrikë.<sup>106</sup></p> <p>Kosova në prill 2023 ka siguruar qasje 100% në internet në territorin e saj duke shënuar shkallën më të lartë të mbulimit në Evropë.<sup>107</sup></p> <p>Në nivel rajonal, Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar memorandumin për krijimin e korridorit digjital të 5G. Ky rrjet premtan transmetim shumë më të shpejtë të të dhënave përmes internetit, rreth 100 herë më shpejt se teknologjia aktuale 4G. Ky memorandum është harmonizuar me marrëveshjen e arritur në Uashington.<sup>108</sup></p> <p>Në shkurt të vitit 2024 është shënuar një hap tjetër drejt digjitalizimit të Trafikut Urban në kryeqytet ku është bërë <b>lidhja me internet në autobusët e Trafikut Urban</b>, duke iu mundësuar udhëtarëve të shfrytëzojnë falas shërbimet e internetit. Kostoja e këtij shërbimi është 2 mijë e 500 euro në muaj, ndërsa synimi është për ta bërë sa më atraktiv transportin publik.<sup>109</sup></p> <p>Në muajin maj 2024 Ministria e Ekonomisë dhe Komuna e Gjilanit, kanë nënshkruar Marrëveshjen e mirëkuptimit, për realizimin e Projektit “Pilotimi i konceptit të Smart City (Neutral Host)” i me bashkëfinancim që ka vlerën 550,000,00 euro. Ky projekt do të adoptoj teknologji të reja, shfrytëzimin eficient të energjisë elektrike, sistemin digjital për menaxhimin e trafikut, mbeturinave dhe ofrimin e shërbimeve digjitale komunale.<sup>110</sup></p>	<p>Kosova duhet të fokusohet në zgjerimin dhe integrimin e teknologjive të avancuara në sektorin e transportit, si biletaria pa letër, inteligjenca artificiale për menaxhimin e trafikut dhe krijimin e korridoreve tjera 5G.</p> <p>Forcimi i bashkëpunimeve me partnerët ndërkombëtarë dhe sigurimi i financimeve shtesë janë kyç për ruajtjen dhe zgjerimin e këtyre iniciativave.</p>
--	---	--	--

104 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër, 2022, fq.37.  
105 Po aty.  
106 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, faqja zyrtare në internet, <https://shorturl.at/VPa7y>  
107 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, 27 nëntor 2023, Prishtinë.  
108 Marrëveshja Shqipëri-Kosovë për korridorin 5G, <https://shorturl.at/udr0C> .  
109 Trafiku Urban, faqja zyrtare në <https://trafikurban-pr.com/2022/ëi-fi-falas/>  
110 Shih lajmin në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, në <https://shorturl.at/LhVNS>



<p><b>18. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Reformën Hekurudhore</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2023 ka konstatuar se Kosova ka bërë progres të kufizuar në vitin 2022 në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore. Qeveria kërkoi kredi për Autostradën e Paqes, por negociatat janë në vazhdim. Punimet hekurudhore në Linjën 10 kanë qenë të ngadalta, me vonesa në sinjalizimin dhe tenderët e telekomit. Kosova dhe Shqipëria planifikojnë një studim për një hekurudhë ndërmjet Durrësit dhe Prishtinës. Ndërsa tregu hekurudhor është hapur, sfidat mbeten në përafrimin me standardet e BE-së. Sistemi i transportit vazhdon të përballet me probleme me sigurinë, mirëmbajtjen dhe kapacitetin rregullator.<sup>111</sup></p> <p><b>Qeveria ka përfshirë në Planin Legjislativ 2024 dy Projektligje, Projektligjin për Hekurudha dhe Projektligjin për Siguri Hekurudhore.</b> Por asnjërin prej tyre ende nuk e ka dërguar në Kuvend për miratim.<sup>112</sup></p> <p>Kosova ka hartuar një kontratë shumëvjeçare të mirëmbajtjes së hekurudhave dhe e ka dorëzuar atë tek autoritetet përkatëse të Komunitetit të Transportit për miratim.<sup>113</sup></p> <p>Negociatat midis Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, për vendosjen e kontrollit me një ndalesë në transportin rrugor dhe hekurudhor, po përparojnë mirë, megjithëse marrëveshjet nuk janë përcaktuar ende. Pikat e përbashkëta të kalimit kufitar hekurudhor (PKK) Hani i Elezit ende nuk kanë filluar të funksionojnë si ndalesa funksionale të PKK-së.<sup>114</sup> Më nëntor 2023, dy tunele të rinovuara janë bërë funksionale në linjën hekurudhore nga kufiri Maqedoni e Veriut-Kosovë deri në Qytetin e Fushë Kosovës, si pjesë e rehabilitimit të Linjës 10 të Hekurudhës.<sup>115</sup></p>	<p>Kosova fillimisht duhet të avancojë <b>projektligjet për hekurudhat dhe sigurinë hekurudhore</b>, të cilat janë pjesë e Planit Legjislativ të vitit 2024, por ende nuk janë dorëzuar në Kuvend për miratim.</p> <p>Tutje, qeveria duhet të fokusohet në finalizimin e negociatave për kredinë për Autostradën e Paqes dhe përsheptimin e projekteve të Rrugës Hekurudhore 10, duke adresuar vonesat në tenderat e sinjalizimit dhe telekomit.</p>
<p><b>19. Përcaktimi i korridoreve për transportin hekurudhor dhe rrugët ujore të brendshme</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Propozimi për rishikimin e Rregullores së Rrjetit Trans-Evropian të Transportit (TEN-T), i cili përfshin një Korridor Hekurudhor të Transportit për Ballkanin Perëndimor, është nën rishikimin e Komisionit Evropian.</p> <p>Pasi të miratohet, RFC-ja e re do të bëhet një mjet thelbësor për bashkëpunim të koordinuar për të përmirësuar trafikun ndërkombëtar të mallrave.<sup>116</sup></p> <p>Si pjesë e Iniciativës së Korridorit Hekurudhor, Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor do të marrin pjesë në Korridoret e Transportit Hekurudhor (KTH), një iniciativë e rëndësishme e Komisionit Evropian që synon ringjalljen e transportit hekurudhor të mallrave në Evropë.</p> <p>Nga ana tjetër, si ekonomi pa dalje në det, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut nuk i kanë dhënë përparësi rregullimit të legjislativitetit detar dhe po bëjnë progres të ngadaltë në këtë fushë.<sup>117</sup></p>	<p>Top of Form</p> <p>Kosova duhet të përcaktojë korridoret hekurudhore dhe të brendshme ujore duke u lidhur me vendet fqinje që kanë qasje në det, duke përmirësuar lidhjet rajonale, duke zhvilluar qendra logjistike dhe duke investuar në infrastrukturën e transportit.</p>

111 Shih Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, fq. 68.

112 Shih Planin Legjislativ të Qeverisë së Kosovës në, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/02/Programi-Legjislativ-per-vitin-2024-.pdf>

113 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër 2022, fq.37.

114 Komuniteti i Transportit, Raporti i Progresit të Planit të Veprimit 2022, fq.12.

115 Faqja zyrtare e qeverisë, Tunelet 6 dhe 7 të linjës hekurudhore Hani i Elezit – Fushë Kosovë përurohen në <https://shorturl.at/QHAY7>

116 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër 2022, fq.38.

117 Po aty, fq.38.



<p><b>20. Përcaktimi i një strategjie të përgjithshme për të zhvendosur trafikun nga rruga në modalitete më miqësore me mjedisin.</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Një <b>Strategji e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar për Ballkanin Perëndimor</b> u përgatit nga Sekretariati i Komunitetit të Transportit dhe u miratua në korrik 2021. Qëllimi i këtij dokumenti është të paraqesë Strategjinë e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar të BE-së dhe të modifikojë qëllimet, momentet e rëndësishme dhe veprimet e BE-së në situatat në rajonin e Ballkanit Perëndimor.<sup>118</sup></p> <p>Në maj të vitit 2023, Kosova ka miratuar <b>“Strategjinë e Transportit Multimodal 2023-2030”</b>. Ajo përfshin përpjekje për të rritur përdorimin e transportit hekurudhor dhe ujon si alternativa më të qëndrueshme dhe të sigurt për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Ky synim ndihmon në reduktimin e ndotjes dhe ngarkesës në rrugë, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.<sup>119</sup></p>	<p>Kosova duhet të fokusohet në <b>zbatimin e Strategjisë së transportit multimodal</b> duke i dhënë përparësi përmirësimeve të nevojshme të infrastrukturës.</p> <p>Monitorimi i progresit dhe ndikimit të strategjisë është thelbësor, me rregullime të bëra në bazë të rezultateve. Angazhimi i palëve të interesuara dhe promovimi i ndërgjegjësimit publik për përfitimet e opsioneve më të gjelbra të transportit do të mbështesë dhe inkurajojë adoptimin më të gjerë.</p>
<p><b>21. Identifikimi i standardeve teknike të BE-së dhe sigurimi i zbatimit dhe i digjitalizimit të të gjitha mënyrave të transportit.</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Plani i veprimit kërkon që Kosova dhe shtetet tjera të rajonit të miratojnë standardet teknike të BE-së për të gjitha mënyrat e transportit dhe të integrojnë teknologjitë digjitale për të përmirësuar operacionet dhe ofrimin e shërbimeve.</p> <p>Kosova është në fazat e hershme të zhvillimit të sistemeve digjitale të transportit. Po bëhen përpjekje për të integruar teknologjitë digjitale në infrastrukturën e transportit, por progresi është i kufizuar. Fokusi përfshin përmirësimin e biletave digjitale, ndjekjen në kohë reale dhe sistemet e menaxhimit. Megjithatë, sfidat mbeten në zbatimin dhe standardizimin e plotë të këtyre teknologjive në të gjitha mënyrat e transportit.</p> <p>Strategjia e Transportit Multimodal për Kosovën 2023-2030 përfshin një fokus në krijimin e një sistemi transporti të zgjuar dhe digjital. Ky objektivi synon të integrojë teknologjitë digjitale në infrastrukturën e transportit për të rritur efikasitetin, sigurinë dhe cilësinë e përgjithshme të shërbimit. Ai pasqyron përkushtimin e Kosovës për të modernizuar sektorin e saj të transportit përmes zgjidhjeve digjitale.<sup>120</sup></p>	<p>Kosova duhet të fillojë zbatimin e teknologjive digjitale të përshkruara në Strategji e transportit multimodal. Kjo përfshin priorizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme digjitale, siç janë sistemet për gjurmimin në kohë reale dhe biletat digjitale. Është gjithashtu e rëndësishme të trajnohet personeli përkatës për të siguruar përdorimin efektiv të këtyre teknologjive.</p> <p>Përveç kësaj, Kosova duhet të monitorojë progresin e përpjekjeve të digjitalizimit, të vlerësojë ndikimin e tyre dhe të bëjë rregullime sipas nevojës për të adresuar çdo sfidë që paraqitet.</p>
<p><b>22. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Përmirësimin e Transportit</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Lehtësimin e Transportit nënkupton përmirësimin e efikasitetit të transportit ndërkufitar duke adresuar çështjet doganore, infrastrukturës dhe rregullatore për të rritur lidhjen dhe për të zvogëluar barrierat logjistike.</p>	

118 Raporti i Komunitetit të Transportit të BE-së 2021, Strategjia e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar në Ballkanin Perëndimor, fq.7.

119 Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030 në, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/STRATEGJIA-E-TRANSPORTIT-MULTIMODAL-2030.pdf>

120 Po aty, fq.4.

<p><b>23. Zbatimi i Planit të Veprimit për Sigurinë Rrugore</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Sigurinë Rrugore përfshin zbatimin e strategjive dhe masave që synojnë përmirësimin e sigurisë rrugore në një rajon. Kjo përfshin aktivitete të tilla si përmirësimi i infrastrukturës rrugore, zbatimi i rregullave të trafikut, kryerja e fushatave të sigurisë dhe përmirësimi i sistemeve të reagimit ndaj emergjencave. Qëllimi është të zvogëlohen aksidentet e trafikut, lëndimet dhe viktimat duke adresuar faktorët kyç që kontribuojnë në reziqet e sigurisë rrugore.</p> <p><b>“Strategjia Multimodale e Transportit 2023-2030”</b> e miratuar nga ana e Kosovës, përfshin qëllime të lidhura drejtpërdrejt me rritjen e sigurisë rrugore, duke synuar përmirësimin në këtë fushë.<sup>121</sup></p> <p>Qeveria ka miratuar vendimin për themelimin e <b>Këshillit të Sigurisë së Trafikut Rrugor (KSTRR)</b>,<sup>122</sup> i cili do të mbajë përgjegjësinë kryesore në përputhje me objektivat e përcaktuara nga politikat qeveritare.</p> <p>Përkundër kësaj, në praktikë, Kosova përballet me shumë viktima në aksidente trafiku.<sup>123</sup></p> <p>Kosova nuk e ka themeluar ende <b>Agjencinë për Siguri Rrugore</b>, e cila përfshin zhvillimin e sistemit kombëtar për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave të aksidenteve rrugor.<sup>124</sup></p>	<p>Për të zbatuar Planin Rajonal të Veprimit për Sigurinë Rrugore, Kosova duhet së pari të rishikojë qëllimet dhe masat e saj. Më pas, të zhvillojë një strategji për t'i zbatuar këto masa në nivel kombëtar, duke u fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, zbatimin e ligjeve të trafikut dhe zhvillimin e fushatave të sigurisë.</p> <p>Koordinimi me partnerët rajonal është thelbësor për të harmonizuar përpjekjet dhe për të shkëmbyer praktikat më të mira. Së fundi, Kosova duhet të monitorojë dhe vlerësojë efektivitetin e masave dhe të përshtatë strategjitë sipas nevojës.</p>
<p><b>24. Zbatimi i Planit të Veprimit për Trafikun Rrugor</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Në shkurt të vitit 2024 Kuvendi i Kosovës ka miratuar <b>Ligjin për rregullat e trafikut rrugor</b>. Ligji i ri fokusohet në përmirësimin e sigurisë rrugore përmes rregulloreve më strikte, standardeve të përditësuara të automjeteve dhe shoferëve dhe përdorimit të zgjeruar të teknologjisë për menaxhimin e trafikut.<sup>125</sup></p> <p><b>Sistemi i Menaxhimit të Aseteve Rrugore (SMAR)</b> është planifikuar dhe buxhetuar për herë të parë në buxhetin e shtetit të Kosovës për vitet 2022-2024.<sup>126</sup></p> <p>Kosova ka përparuar me finalizimin e Udhëzimit Administrativ të Direktivës së Sistemit Inteligjent të Transportit.<sup>127</sup></p> <p>Kosova ende nuk i ka zbatuar rekomandimet e përshkruara në raportin e projektit të Asistencës Teknike për Lidhshmëri në Ballkanin Perëndimor (CONNECTA) që synon rritjen e cilësisë së rrjetit rrugor.<sup>128</sup></p> <p>Drafti i aktit nënligjor për përafrimin e Direktivës 2008/69/EC për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore dhe aktit nënligjor për inspektimet teknike periodike në rrugë, nëse nuk është finalizuar ende. Gjithashtu, duhet të krijohet një sistem/model për të rritur kapacitetin e inspektorëve dhe auditorëve të sigurisë rrugore.<sup>129</sup></p>	<p>Kosova duhet të finalizojë aktet nënligjore për tu përafruar me direktivat e BE-së për sigurinë rrugore, të zbatojë rekomandimet nga projekti CONNECTA për të përmirësuar cilësinë e rrugëve dhe të rrisë kapacitetin e inspektorëve të sigurisë rrugore. Për më tepër, ajo duhet të <b>monitorojë zbatimin e Ligjit të ri të trafikut rrugor</b>.</p>

121 Strategjia e Transportit Multimodal të Kosovës 2030, fq. 5.

122 Qeveria e Kosovës, Vendimet nga Mbledhja 198, fq. 12.

123 Shih Betimi për Drejtësi n], <https://shorturl.at/zPKpU>

124 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.109.

125 Shih Ligjin për Trafikun rrugor në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=87975>

126 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër 2022, fq.41.

127 Po aty, fq. 41.

128 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq. 110.

129 Po aty, fq. 109.

<p><b>25. Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike për rrjetet e transportit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Asnjë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk ka përgatitur apo miratuar ndonjë strategji të synuar të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e transportit.<sup>130</sup></p> <p>Deri më tani, Kosova ka krijuar vetëm një grup pune për hartimin e <b>Strategjisë Kombëtare për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike</b>, duke synuar përfshirjen e planeve të qëndrueshmërisë klimatike në rrjetin e transportit.<sup>131</sup></p>	<p>Kosova duhet të fillojë hartimin e Strategjisë Kombëtare për Përshtatjen e Ndryshimeve Klimatike sa më shpejt të jetë e mundur dhe të përfshijë në këtë Strategji edhe aspektin e transportit.</p>
<p><b>26. Promovimi i përgatitjes dhe zbatimit të Planeve të Qëndrueshme të Lëvizjes Urbane për zonat urbane të Ballkanit Perëndimor</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunitat</p>	<p>Në <b>Strategjinë e Kosovës për Transportin Multimodal 2023-2030</b>, synohet që të rregullohet multimodaliteti i transportit, duke përfshirë të gjitha llojet e transportit dhe lëvizshmërinë urbane.<sup>132</sup></p> <p>Kryeqyteti i Prishtinës ka hartuar <b>Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban</b>, por një plan i tillë mungon në komunitet e tjera.<sup>133</sup></p>	<p>Bazuar në Modelin e Prishtinës edhe komunitet tjera duhet të hartojnë Planet e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban.</p>
<p><b>27. Përcaktimi i zgjidhjeve për lëvizshmëri të qëndrueshme në nivel rajonal përfshirë planet për zhvillimin e karburanteve alternative.</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Përdorimi i energjisë së ripërtëritshme në sektorin e transportit në shtetet e Ballkanit Perëndimor është pothuajse inekzistent dhe asnjëra prej tyre nuk ka miratuar Direktivën e BE-së të Infrastrukturës Alternative të Karburantit, e cila përcakton kërkesat minimale për infrastrukturën e karburanteve alternative. Për më tepër, Direktiva (BE) 2018/2001 për promovimin e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme nuk është transpozuar në asnjënga shtetet.<sup>134</sup></p> <p>“Trafiku Urban”, kompani e transportit publik në kuadër të Komunitet të Prishtinës, ka lidhur një Marrëveshje Kredie prej 10 milionë eurosh me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për prokurimin e 6 autobusëve elektrikë.<sup>135</sup></p>	<p>Kosova duhet të miratojë dhe zbatojë Direktivën e BE-së për Infrastrukturën Alternative të Karburantit për të standardizuar infrastrukturën alternative të karburantit. Përveç kësaj, Kosova duhet të transpozojë Direktivën (BE) 2018/2001 për të promovuar përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në sektorin e transportit, duke synuar rritjen e pjesës së energjisë së ripërtëritshme dhe mbështetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme të transportit.</p>
<p><b>27a. Përcaktimi i një plani për ndërtimin e stacioneve të furnizimit për automjetet elektrike.</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Ekonomisë</p>	<p>Në muajin maj 2024 kompania energjetike publike KESCO ka njoftuar se ka instaluar stacione për mbushjen e automjeteve elektrike në të gjitha rrethet në Kosovë si pjesë e iniciativës së saj për promovimin e automjeteve elektrike dhe uljen e ndotjes së ajrit. Me mbi 74,000 euro të investuara në infrastrukturën e furnizimit, KESCO synon të mbështesë një mjedis më të pastër dhe kosto më të ulëta.<sup>136</sup></p>	<p>Kosova duhet të vlerësojë efektivitetin e stacioneve të furnizimit për veturat elektrike, të zgjerojë rrjetin në dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut lidhur me përdorimin e automjeteve elektrike.</p>
<p><b>28. Forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e zhvillimit të infrastrukturës për alternativat e karburantit.</b></p>	<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>Progresi i përgjithshëm në bashkëpunimin rajonal në fushën e zhvillimit të infrastrukturës së karburanteve alternative ka qenë i kufizuar.</p> <p>Vlerësimi i përgjithshëm i përmirësimit në fushën e qëndrueshmërisë klimatike dhe karburanteve alternative e vlerëson Kosovën me 8% në vitin 2020 dhe 2021 dhe 0% në vitin 2021 dhe 2022.<sup>137</sup></p>	<p>Kosova duhet të bashkëpunojë me vendet fqinje dhe organet rajonale, të marrë pjesë në projekte të përbashkëta, të harmonizojë rregulloret me standardet rajonale dhe të kërkojë financim dhe mbështetje për të avancuar zhvillimin e infrastrukturës së karburanteve alternative.</p>

130 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër 2022, fq. 42.  
131 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 24 nëntor 2023, Prishtinë.  
132 Strategjia e Transportit Multimodal të Kosovës 2023-2030, fq. 21.  
133 Plani i Mobilitetit të Komunitet të Prishtinës, në [https://prishtinaonline.com/uploads/sump\\_pristina\\_final\\_report\\_alb.pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/sump_pristina_final_report_alb.pdf)  
134 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër 2022, fq. 42.  
135 Shih më shumë në, <https://shorturl.at/TE2yJ>  
136 Shih më shumë në, <https://shorturl.at/whtwA>  
137 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër 2022, fq.43.